



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 54/2019 (JR)  
Datë 28.10.2019

Nr. 19 i vendimit  
Datë 13.07.2021

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 13.07.2021, ditën e martë, në orën 11:55, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Alfred Agolli, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 177, datë 08.07.2019.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 1, 2, 63 dhe 66 pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, me objekt ndryshimin e vendimit nr. 177, datë 08.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Alfred Agolli (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurorit dhe drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit iu nënshtrua rivlerësimit *ex officio*, me shortin e hedhur nga Komisioni më datë 15.01.2018. Mbështetur në përcaktimet e neneve 31-33, 34-39 dhe 40-44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Grupi i Punës së Prokurorisë së Përgjithshme.

1.1. Pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar<sup>1</sup>, duke konstatuar se:

- i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
- ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2. Pasi kreu procedurën e kontrollit të figurës, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin e rishikuar me konstatimin për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e ushtrimit të detyrës<sup>2</sup>.

1.3. Prokuroria e Përgjithshme ka dërguar raportin<sup>3</sup> mbi vlerësimin e aftësive profesionale që bazohet në vlerësimin e tri dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës 08.10.2013 – 08.10.2016, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe në informacionin nga burimet arkivore.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikuar (në vijim “Komisioni”) kreu procesin e rivlerësimit për të tria kriteret, duke konstatuar për secilin prej tyre si vijon.

2.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për sa i përket pasurisë “apartament banimi me sip. 68,5 m<sup>2</sup>”, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastër, subjekti i rivlerësimit:

<sup>1</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 08.01.2018.

<sup>2</sup> Deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr. {\*\*\*}, datë 14.05.2019.

<sup>3</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 17.04.2018.

- ka kryer deklarin të pamjaftueshëm dhe të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me burimin e ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e apartamentit;
- ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. N. Dh., për dhënien e huas në shumën 3.000.000 lekë;
- i ka dhënë Komisionit përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me huan e marrë nga z. N. Dh..

2.2. Për kriterin e kontrollit të figurës, nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

2.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: të metat e konstatuara në shqyrtimin e dosjeve të trajtuara gjatë procesit, reflektojnë mangësi profesionale të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit; të tilla mangësi konsiderohen moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, mënyra jokorrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenet 73, pikat 2 dhe 3 dhe 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

3. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë dhe në vlerësimin tërësor të çështjes ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë. Bazuar në nenet 58, pika 1, germa “c” dhe 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

### **III. Shkaqet e ankimit**

4. Kundër vendimit të sipërcituar të Komisionit ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit, me objekt ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të tij. Ankimi mbështetet në nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin F të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”), në nenet 1, 2, 63 dhe 66 pika 1, germa “b” të ligjit nr. 84/2016, në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “K.Pr.Administrative”), në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë (në vijim “K.Pr.Civile”) dhe në nenin 46 e vijues të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”).
5. Subjekti i rivlerësimit parashtron në ankim shkaqe që lidhen me shkelje procedurale dhe të vlerësimit në themel të kriterëve të pasurisë dhe të aftësive profesionale, duke pretenduar se vendimi është i pabazuar në ligj, i marrë mbi bazën e një hetimi dhe vlerësimi administrativ të paplotë, të pabazuar në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, është rezultat i cenimit e shkeljes së normave dhe rregullave ligjore për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe të vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike, të vërtetuara gjatë procesit administrativ.

5.1. Pretendimet lidhur me shkeljet procedurale fokusohen kryesisht në procedurën e ndjekur nga Komisioni për marrjen e provave, analizimin e tyre dhe njoftimin mbi nivelin e përdorshmërisë së

tyre, të cilën subjekti i rivlerësimit e analizon në funksion të së drejtës së mbrojtjes, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se:

- Komisioni ka cenuar parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, si dhe ka kryer shkelje procedurale në mënyrën se si ka marrë dhe vlerësuar provat e paraqitura prej tij në hetimin administrativ, duke e kthyer seancën e datës 08.07.2019, në një seancë tërësisht formale.
- Komisioni nuk ka arsyetuar mbi provat shkresore të paraqitura prej tij, sikurse deklaratat noteriale nga dëshmitarët, duke i konsideruar të papërdorshme në momentin e arsytimit të vendimit, ndërkohë që nuk i ka refuzuar si të tilla, duke e vendosur në disavantazh dhe duke cenuar standardet e detyrueshme për t'u zbatuar që rrjedhin nga parimi i kontradiktorialitetit.
- Komisioni e ka ftuar [subjektin] në seancë dëgjimore në kundërshtim me nenet 42, pika 1 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenet 45 dhe 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59 dhe 87, pika 2, germa “ç” e K.Pr.Administrative, si dhe në kundërshtim me pikat 10 dhe 11 të aktit “Hapat procedurale të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, duke mos i dhënë mundësi të njihej dhe të mbrohej në seancë dëgjimore ndaj rezultateve përfundimtare të hetimit, pas përgjigjeve të dërguara prej tij.
- Sjellja e trupit gjykues të Komisionit nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, elemente thelbësore këto për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, referuar jurisprudencës së GjEDNj-së në çështjen e Belilos kundër Zvicrës.
- Komisioni, duke paragjykuar çështjen dhe paracaktuar vendimin, nuk ka përmbushur e respektuar detyrimet dhe normat kushtetuese e ligjore, dhe veprimet e ndërmarra gjatë procesit bien ndesh me parimet e sigurisë juridike, gjykimin e drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë.
- Komisioni, duke përfituar nga statusi i dyfishtë hetues dhe vendimmarrës, ka cenuar të drejtën për t'u mbrojtur dhe parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.
- Komisioni ka vepruar nën doza të larta paragjykimi dhe në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë.
- Komisioni ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme edhe për shkak të mosnjohimit të anëtarëve të trupit gjykues dhe këshilltarëve në kohë reale, që ka përbërë pamundësi objektive për verifikimin dhe shqyrtimin e pretendimit për ekzistencën e konfliktit të interesit, ndërkohë që nuk ka asnjë njohim lidhur me vendimin për dorëheqjen e komisioneres dhe procedurën e zëvendësimit të saj. Shkaku i kërkesës nuk qëndron, pasi nuk ka pasur kallëzime të regjistruara ndaj saj nga z. Ç..
- Komisioni ka shkelur parimin e barazisë para ligjit, të mosdiskriminimit dhe, për rrjedhojë, edhe të sigurisë juridike, pasi e ka trajtuar subjektin e rivlerësimit në mënyrë të diferencuar nga subjektet e tjera të gjykuara në mënyra të ndryshme për situata të njëjta objektive, duke krijuar besimin te subjektivizmi i vlerësimit të provave.
- Vendimi është tërësisht alogjik sepse konkluzioni për vlerësimin e pasurisë nuk qëndron në raport me figurën, moralin dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**5.2.** Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë, të grupuara sipas natyrës përkatëse.

**5.2.1.** Në kontekstin e dispozitave të *Kushtetutës* dhe *ligjit*, subjekti pretendon se:

- Ka plotësuar detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara, nuk rezulton nga hetimi administrativ të jenë ngritur pretendime për deklarim të rremë apo për fshehje pasurie, të cilat mund ta vendosnin në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, germat

“b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016. Për të njëjtat arsye, nuk mund të gjendet në kushtet e aplikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84 /2016 apo në kushtet e konfliktit të interesit.

- Nuk konstatohet asnjë pasaktësi në deklaratën *vetting*; pasuritë dhe të ardhurat janë deklaruar në mënyrë të rregullt, ashtu siç është provuar bindshëm edhe burimi i ligjshëm i krijimit të tyre. Pasaktësitë në mënyrën e plotësimit të deklarimeve periodike nuk kanë të bëjnë me mosdeklarimin e pasurisë apo mosdeklarimin e burimit të krijimit të të ardhurave për vënien e kësaj pasurie, nuk dëshmojnë për përpjekje për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim dhe për asnjë moment nuk cenojnë apo vënë në diskutim të provuarit bindshëm të burimit të krijimit të ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të deklaruara në deklarimin *vetting* prej tij.
- Konkluzioni i Komisionit që subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për pasurinë është i hamendësuar, i pavërtetë, në kundërshtim me ligjin dhe bazohet në fakte të interpretuara qëllimisht në mënyrë të gabuar; nuk janë marrë në konsideratë konkluzionet e ILDKPKI-së, e cila nuk ka marrë asnjë masë ndër vite ndaj subjektit të rivlerësimit.
- Masa e shkarkimit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 aplikohet kur plotësohen në mënyrë kumulative dy kriteret – pamjaftueshmëri në kontrollin e figurës dhe në kriterin e pasurisë, gjë që nuk ka ndodhur në rastin e subjektit të rivlerësimit pasi në kontrollin e figurës nuk janë konstatuar probleme.
- Aplikimi i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për shkak të kriterit të vlerësimit të pasurisë nuk është i përligjur pasi deklarimi i pamjaftueshëm, referuar parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duhet të përbëjë sjelljen më të rëndë, e cila duhet të ketë të njëjtin nivel kundërligjshmërie sikurse janë shkeljet e renditura në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
- Komisioni ka mbajtur qëndrime të ndryshme për qëllimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke cenuar parimin e barazisë para ligjit të subjekteve të rivlerësimit.
- Pasaktësitë në deklarime ndër vite duhet të analizohen në tërësi. Ato nuk mund të përbëjnë tregues të fshehjes apo deklarim të rremë të pasurisë në kuptim të kësaj dispozite.
- Besueshmëria në ligjshmërinë e krijimit të pasurisë duhet të bazohet në bindje të krijuara mbi fakte, prova dhe parashikime ligjore. Ligji dhe procesi nuk mund të kenë për qëllim apo frymë penalizimin e subjekteve të rivlerësimit për shkak të pasaktësive në deklarim, pasi mungon dashja apo qëllimi për të bërë deklaram të rremë.

**5.2.2.** Në kontekstin e *kontrollit të pasurisë*, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

- Mosdeklarimi në deklaratën *vetting* i huas prej 3.000.000 lekësh nga z. N. Dh., si burim krijimi i pasurisë apartament [*me sipërfaqe 68,5 m<sup>2</sup>, në Gjirokastër*] ka ndodhur për shkak se ka qenë një hua e marrë për një afat të shkurtër kohor, me qëllim përfundimin e procedurave të kredisë. Ka kaluar një kohë e gjatë dhe subjekti është kujtuar për këtë fakt kur Komisioni e ka njohur me rezultatet e hetimit administrativ.
- Saktësimi i datave që i përkasin një periudhe të largët nuk mund të interpretohet si ndryshim deklarimi apo deklarim kontradiktor. Deklarimi në deklaratën *vetting* se çmimi i shitjes është likuiduar më datë 22.06.2007, ditën kur është lëvruar kredia, ka një lapsus të paqëllimshëm. Subjekti është bërë pronar më datë 20.06.2007, kur është nënshkruar kontrata e shitjes dhe është likuiduar çmimi me huan e marrë nga z. Dh.. Në të njëjtën datë janë kryer edhe procedurat pranë ZVRPP Gjirokastër.
- Ka shpjeguar bindshëm që qëllimi i marrjes së huas prej 3.000.000 lekësh ishte pagesa shitësit [V. B.] për të firmosur aktin e shitjes. Shitësi kërkonte lekët *cash* në dorë në datën 20.06.2007, gjë që vërtetohet edhe nga deklaratat noteriale e z. B., e paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit.

- Përdorimi i huas në vlerën 3.000.000 lekë për pagimin e apartamentit, është provuar me dokumentacion. Komisioni duhet të kishte marrë dëshminë e komisioneres F. Sh., e cila në vitin 2007 ka qenë noterja që ka nënshkruar kontratën dhe ishte në dijeni të plotë të ngjarjeve.
- Mënyra e likuidimit të çmimit është pasqyruar pasaktësisht në kontratë. Vullneti i palëve, i shprehur në kontratën e datës 08.06.2007, ishte që shitja do të bëhej pasi të lëvrohej kredia.
- Shlyerja e huas është bërë *cash* në dorë, me kërkesën e huadhënësit [z. N. Dh.]. Ky fakt provohet me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.06.2019.
- Shpjegimet e tij [subjektit] nuk janë kontradiktore, por mund të ketë ndonjë lapsus në datat e referuara për kryerjen e veprimeve. Nuk duhet anashkaluar fakti se ngjarjet kanë ndodhur përpara 12 viteve, ndërsa kërkohen shpjegime të hollësishme për veprime të realizuara asokohe, në harkun kohor të 4-5 ditëve kalendarike.
- Në asnjë moment nuk ka kryer veprime ose mosveprime në kundërshtim me ligjin. Gjithmonë ka deklaruar se burimi i krijimit të apartamentit është kredia e marrë te Raiffeisen Bank, pasi qëllimi i vërtetë i kredisë del edhe nga ecuria e shlyerjes së saj.
- Nga të dhënat e administruara nga institucionet duket qartë se z. Dh. ka të ardhura të mjaftueshme kundrejt vlerës së huas prej 3.000.000 lekësh. Kjo vërtetohet edhe nga akti i ekspertimit – bashkëlidhur ankimit – që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të çiftit Dh.
- Ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk ka pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Ndaj, edhe shkaqet kushtetuese që sjellin automatikisht prezumimin në favor të masës disiplinore të shkarkimit, nuk vërtetohen dhe, në zbatim të parimit të proporcionalitetit, “pasaktësitë” e konstatuara nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë dhe nuk cenojnë figurën e gjyqtarit/prokurorit dhe as besimin e publikut te drejtësia.

**5.2.3.** Në përmbajtje të pretendimeve të sipërcituara, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar:

- thirrjen e znj. R. Dh., në cilësinë e dëshmitares dhe në cilësinë e drejtueses së bankës e jo të huadhënësit, duke qenë se për këtë të fundit, cilësinë e ka pasur bashkëshorti i saj;
- riçeljen e hetimit për të thirrur në cilësinë e dëshmitares komisioneren F. Sh., e cila ka qenë në dijeni të marrëdhënies me shitësin, për shkak të punësimit të saj të mëparshëm si notere;
- thirrjen e z. B. si dëshmitar.

**5.3.** Në lidhje me konkluzionet e Komisionit për *kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

- Komisioni ka kryer interpretim të zgjeruar të pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi cenimi i besimit të publikut te drejtësia aplikohet në rast se subjekti ka cenuar të tria kriteret dhe, për rrjedhojë, ushtrimi i mëtejshëm i detyrës prej tij vlerësohet i pamundur për shkak se është cenuar besimi i publikut te drejtësia.
- Komisioni në vlerësimin e këtij kriteri nuk merr në konsideratë raportin e Prokurorisë së Përgjithshme, apo qëndrimin korrekt dhe bashkëpunues të tij përgjatë procesit, gjë që përbën cenim të parimit të objektivitetit.
- Vlerësimi i Komisionit nuk mbështetet në prova, gjë që përbën shkelje të parimit themelor të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, të sanksionuar në nenet 7 dhe 145, pikat 1 dhe 3 të Kushtetutës.
- Komisioni ka marrë përsipër të bëjë rolin e gjykatës. Konkluzioni lidhur me vendimin e mosfillimit të vitit 2013 është i gabuar dhe bie ndesh me legjislacionin procedural penal, duke anashkaluar faktin se është në diskrecionin e prokurorit që të vlerësojë nëse duhet ta fillojë apo

jo çështjen penale, bazuar në të dhënat fillestare të rastit dhe në indiciet për ekzistencën e veprave penale.

- Komisioni ka anashkaluar problematikat e evidentuara nga Prokuroria e Përgjithshme – referuar ankesës së z. F. D. – lidhur me ndarjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit në një procedim të lidhur, administrimin e provave dhe pushimin e procedimit, të cilat i përkasin një prokurori tjetër që ka pasur çështjen në hetim para se t’i ngarkohej atij për hetim. Subjekti vijon të ketë bindjen në vlerësimin që i ka bërë çështjes.
  - Bindja e brendshme për kërkesën për masën e sigurimit personal për z. K. H., është mbështetur në ligjin procedural penal, kushtet dhe kriteret ligjore, ndërkohë që Komisioni e ka trajtuar çështjen si gjykim themeli.
  - Komisioni nuk ka marrë parasysh shpjegimet e tij gjatë hetimit administrativ, arsyetimin e vendimeve dhe bazën ligjore, parimet e objektivitetit dhe të proporcionalitetit në konkluzionin e arritur për cenimin e besimit të publikut.
  - Vlerësimi i Komisioni është i padrejtë jo vetëm për shkak të mosrespektimit të normave procedurale që garantojnë procesin e rregullt ligjor, por edhe për thelbin e tij pasi, nga denoncimet e publikut, nuk rezultuan rrethanat që mund të rëndojnë pozitën e tij dhe se vlerësimi i një rasti të vetëm nuk mund të shërbejë si standard i drejtë për të konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë.
6. Subjekti i rivlerësimit kërkon shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, me praninë e tij dhe riçeljen/përsëritjen e hetimit gjyqësor, pasi vlerëson të nevojshëm debatin gjyqësor në kushtet kur vendimi është marrë bazuar në shkelje të rënda procedurale, si dhe në konstatimin e gabuar dhe në mënyrë jo të plotë të gjendjes faktike të pasurisë dhe aftësive profesionale, marrjen e provave të reja bashkëlidhur ankimit, si dhe/ose rimarrjen e disa provave të marra në Komisioni, me qëllim zgjidhjen e drejtë të çështjes. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur ankimit një sërë aktesh, në cilësinë e provës<sup>4</sup>. Në përfundim, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit kërkon:
- 6.1. Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.
  - 6.2. Ndryshimin e vendimit nr. 177, datë 08.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
  - 6.3. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Agolli, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

---

<sup>4</sup> Bashkëlidhur ankimit gjenden: deklarata noteriale, datë 11.10.2019, e z. V. B. – [nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.]; deklarata noteriale e z. N. Dh., datë 27.06.2019 – [nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.]; nxjerrje e llogarisë bankare të znj. R. Dh.; shkresa veprimi arke, datë 25.06.2007, me përmbajtje tërheqje kredie bankare, cash me vlerë 3.000.000 lekë, Raiffeisen Bank; 4 (katër) mandate arkëtimi pranë ZVRPP Gjirokastrë, të datave 20 dhe 22.06.2007, arkëtuar nga z. V. B. dhe subjekti i rivlerësimit; 2 (dy) shkresa nga Raiffeisen Bank, si dhe kopje e plotë e dokumentacionit të kredisë së marrë në vitin 2007; raport vlerësimi pasurie të paluajtshme, datë 14.06.2007, për porositësin Raiffeisen Bank, pronar V. B. dhe klient Alfred Agolli; vendimi i Komisionit nr. 2, datë 29.10.2018, për pranimin e kërkesës së komisioneres F. Sh. për dorëheqje si anëtare e trupit gjykues që do të shqyrtonte dosjen e subjektit të rivlerësimit; raporti/relacioni i Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me inspektimin e Ministrisë së Drejtësisë për kontrollin e ushtruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për periudhën 2013 –2014; propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm drejtuar Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të prokurores R. Gj.; akt ekspertimi kontabël i hartuar me kërkesë të subjektit të rivlerësimit nga kontabiliste e miratuar J. L., datë 09.10.2019; 2 (dy) ekstrakte nga QKB-ja për personin fizik N. Dh., për veprimtarinë e ushtruar në fushën tregtim këpucësh dhe bar kafe; vendime të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që u përkasin gjashtë (6) subjekteve të ndryshme të rivlerësimit, respektivisht: I. T., F. M., A. K., E. N.; K. B. dhe A. D. (ky i fundit i pacituar në listë); prokurorë e posaçme, datë 07.10.2019, për përfaqësim me tagra gjithëpërfshirës nga avokatët A. R. dhe avokat E. B. në procesin që lidhet me ankimin kundër vendimit të Komisionit (shtuar me shkrim dore).

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

##### A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, që në këtë rast ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* duke qenë subjekt rivlerësimi, në kuptim të nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës. Ankuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi e ka paraqitur ankimin brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit (02.10.2019 – 16.10.2019<sup>5</sup>). Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, i nënshtrohet parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, sipas të cilit shqyrtimi i ankimit në dhomën e këshillimit bëhet në bazë të dokumenteve.
8. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”), me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është rezultat i shortit të datës 20.04.2021<sup>6</sup>.
9. Fillimisht, trupi gjykues i Kolegjit analizoi kërkesat procedurale të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në përmbajtje të ankimit, që kanë të bëjnë kryesisht me kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, riçeljen e hetimit gjyqësor, rivlerësimin e provave të administruara nga Komisioni, administrimin e akteve bashkëlidhur ankimit në cilësinë e provave, si dhe thirrjen e dëshmitarëve.

**9.1.** Në zbatim të parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procesi gjyqësor në Kolegj zhvillohet sipas një grupi dispozitash të ligjit nr. 49/2012, përfshirë nenet 47, 49 dhe 51 të këtij ligji. Në këtë dritë, nga leximi harmonik i parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për sa u përket provave, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i provave dhe akteve të administruara gjatë procesit të zhvilluar në Komision, është pjesë e qenësishme e procedurës së analizimit të shkaqeve të ankimit nga Kolegji. Aktet bashkëlidhur ankimit nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas dhënies së vendimit të Komisionit. Si rrjedhojë, nuk mund të argumentohet që paraqitja e tyre në Komision ka qenë e pamundur. Ky konstatim vlen edhe për aktet që mbajnë datat pas dhënies së vendimit, sikurse: i) deklarata e z. B. [datë 11.10.2019]; ii) akti i ekspertimit kontabël [datë 09.10.2019]; iii) dy ekstraktet nga QKB-ja për veprimtaritë që ushtron z. Dh. [datë 09.10.2019], apo akte të tjera të nxjerra shumë kohë përpara dhënies së vendimit, sikurse vendimi nr. 2/2018 i Komisionit për pranimin e kërkesës për dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes të komisioneres, znj. Sh. [kërkuar Komisionit më datë 08.10.2019], raporti/relacioni i Prokurorisë së Përgjithshme mbi gjetjet e inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, që mban datën 08.05.2015 dhe propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm, datë 25.07.2008, dërguar Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të prokurores R. Gj. [kërkuar Prokurorisë së Përgjithshme më datë 08.10.2019].

**9.2.** Në përmbledhje, ndërsa aktet që datojnë përpara vendimit, subjekti kishte mundësi t’ia paraqiste Komisionit për të plotësuar mbrojtjen e tij, të tjerat nuk bazohen në të dhëna të reja. Po

---

<sup>5</sup> Vendimi i Komisionit nr. 177, datë 08.07.2019, i është njoftuar nëpërmjet shërbimit postar subjektit të rivlerësimit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 01.10.2019 (me shënimin e marrjes në dorëzim nga Alfred Agolli më datë 02.10.2019). Ankimi është regjistruar pranë Komisionit me nr. {\*\*\*} prot., datë 16.10.2019.

<sup>6</sup> <http://kpa.al/njoftim-495/>



kështu, edhe pse subjekti i rivlerësimit është shprehur në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ se deklaratën e z. B., për shkaqe pamundësie (z. B. ndodhej jashtë shtetit për çështje shëndetësore), do ta paraqiste në “afatin më të hershëm të mundshëm”, sërish paraqitja e saj në këtë fazë – bashkëlidhur ankimit – nuk plotëson kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit provat e reja në ankim mund të paraqiten vetëm në kushtet kur ankuesi provon pamundësinë për t’i paraqitur ato në shqyrtimin në shkallë të parë. Në rrethanat konkrete, kur për herë të parë subjekti i rivlerësimit është pyetur në maj 2018 për mënyrën e kryerjes së pagesës 3.000.000 lekë ndaj z. B., dhe vendimi është marrë 17 muaj më pas [18 korrik 2019], qartësisht subjekti kishte kohë të mjaftueshme për ta paraqitur këtë akt edhe më herët gjatë procesit në Komision.

**9.3.** Një pjesë e akteve bashkëlidhur ankimit janë paraqitur edhe gjatë procesit të hetimit në Komision, sikurse deklarata noteriale e z. Dh. e datës 27.06.2019, apo edhe dokumentacioni që lidhet me marrjen e kredisë në vitin 2007, i vënë në dispozicion nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ, por edhe nga Raifeisen Bank<sup>7</sup>. Sa u përket vendimeve të Komisionit të cilat subjekti ia ka bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues sjell në vëmendje që këto përbëjnë informacione nga burime të hapura – janë lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të Komisionit – çka e bën paraqitjen e tyre të panevojshme. Ndërsa, kërkesa për thirrjen në cilësinë e dëshmitarëve të znj. R. Dh. dhe z. V. B. është kërkesë e përsëritur. Subjekti e ka parashtruar këtë kërkesë edhe në Komision gjatë procesit të hetimit administrativ – në përgjigjet e pyetjeve shtesë, përcjellë më datë 21.10.2018. Komisioni ka shpjeguar në përmbajtjen e rezultateve të hetimit administrativ arsyet përse ka marrë një nga tri dëshmitë e propozuara nga subjekti. Për rrjedhojë, plotësimi i kësaj kërkesë nga Kolegji është i panevojshëm në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes.

**9.4.** Edhe kërkesa e subjektit të rivlerësimit për të thirrur komisioneren F. Sh. në cilësinë e dëshmitares rezulton të mos plotësojë kushtet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, pasi ndonëse subjekti i rivlerësimit kishte mundësi ta thërriste komisioneren në këtë cilësi gjatë zhvillimit të procesit në Komision, nga shqyrtimi i akteve nuk rezulton që një kërkesë e tillë të jetë parashtruar prej tij gjatë zhvillimit të procesit të hetimit. Përpos kësaj, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikujt e Komisionit, të përcjellë në Kolegji, rezultojnë të dhëna dhe informacione të mjaftueshme për vlerësimin nga trupi gjykues të faktit nëse pretendimet e subjektit janë bindëse. Kjo çështje është trajtuar gjerësisht në pjesën arsyetuese të vendimit që u përket shkaqeve të ankimit për kriterin e pasurisë.

- 10.** Në vijim të analizës ligjore të kryer, trupi gjykues i Kolegjit çmoi që gjykimi të vijojë në dhomë këshillimi sipas nenit 49 të ligjit nr. 49/2021, pasi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit nuk plotësojnë kushtet e nenit 47 të këtij ligji. Trupi gjykues vlerësoi të mos pranojë aktet për të cilat u kërkua të administrohen nga subjekti në cilësinë e provës, në kushtet kur zbatohen përcaktimet e nenit 49, pika 6, germet “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016 – pasi marrja e provave rezultoi e panevojshme dhe e parëndësishme në zgjidhjen e çështjes dhe njëkohësisht nuk identifikohet plotësimi i asnjë prej kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012<sup>8</sup>.

---

<sup>7</sup> Në përgjigje të shkresës të datës 12.02.2018, banka ka përcjellë, ndër të tjera, kopje të kontratës së kredisë, kontratës së shitjes së pasurisë, deklaratën noteriale të z. Dh. më datë 21.06.2007 dhe dy certifikata të subjektit – personalen dhe familjaren.

<sup>8</sup> Neni 51, pika 1 përcakton që: “[...] 1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje

*B. Vlerësimi i pretendimeve që lidhen me cenimin e parimeve procedurale*

11. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka kryer shkelje të neneve 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, të ligjit nr. 84/2016, të nenit 183 të K.Pr.Civile, të nenit 48 të K.Pr.Administrative dhe të dispozitave të ligjit nr. 49/2012, pasi ka arritur në konkluzione pa konsideruar të gjitha provat e depozituara gjatë procesit të rivlerësimit. Subjekti parashtron po ashtu edhe që Komisioni ka shkelur parimet procedurale për mënyrën e administrimit të kërkesave për marrjen e provave, analizimin e tyre dhe njoftimin mbi nivelin e përdorshmërisë së tyre. Komisioni nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës së tij për thirrjen e tre dëshmitarëve, duke arsyetuar vetëm në vendim se kërkesa ishte e pabazuar në nenin 49, pikat 8 dhe 6 të ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që ai duhet të ishte njoftuar brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës për marrjen e vendimit të ndërmjetëm. Sipas subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 49, pika 9 dhe 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nenin 183 të K.Pr.Civile, nenet 25 dhe 34 të ligjit nr. 49/2012, me vendim të ndërmjetëm Komisioni duhet të disponojë edhe kryesisht mbi kërkesat lidhur me marrjen e provave që janë kërkuar pas kalimit të barrës së provës, duke mbajtur të informuara palët në proces me vendime të arsyetuara dhe duke respektuar të drejtën e mbrojtjes.

11.1. Në analizë të akteve në fashikull, përfshirë aktet procedurale të hartuara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar thirrjen e 3 dëshmitarëve në përgjigjet e tij kundrejt pyetjeve shtesë të Komisionit më datë 21.10.2018. Në vijim, më datë 05.02.2019, Komisioni ka thirrur në cilësinë e dëshmitares znj. R. Dh.. Mënyra se si është trajtuar kjo kërkesë pasqyrohet nga Komisioni me hollësi në rezultatet e hetimit administrativ, në faqen 7. Nga shqyrtimi i përgjigjeve të rezultateve të hetimit administrativ, përcjellë nga subjekti më datë 01.07.2019, dhe më tej përmbajtjes së procesverbalit të seancës dëgjimore, nuk konstatohet që subjekti të ketë rishprehur kërkesë specifike, të ketë kërkuar arsyetim plotësues apo sqarime për mosthirrjen e dëshmitarëve të tjerë apo të ketë parashtruar paqartësi lidhur me adresimin e kërkesës së tij të parashtruar më herët, në tetor 2018. Në vendimin përfundimtar, Komisioni është shprehur se *vendosi* mospranimin e kërkesës së subjektit për të thirrur dëshmitarët e tjerë pasi fakti që u kërkuar të provohej me dëshmitarë nga subjekti i rivlerësimit, ishte provuar gjatë hetimit. Më tej, bazuar në nenin 232 të Kodit të Procedurës Civile, në kushtet e ekzistencës së një dokumentacioni zyrtar, Komisioni vendosi të mbështetej në këtë të fundit, e konkretisht, në kontratën e shitblerjes, kryer përpara një noteri publik, akt i cili juridikisht ka vlerë të plotë, deri në provën e kundërt.

11.2. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni nuk ka zbatuar me korrektësi rregullat e përcaktuara prej vetë atij, në kushtet kur nuk është shprehur brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për thirrjen e dëshmitarëve, sikurse parashikon pika 8 e rregullores së Komisionit “Për hapat proceduralë të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese

---

*të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë”.*

të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”<sup>9</sup>, i ndryshuar. Megjithatë, kjo situatë nuk përbën shkak për të vlerësuar se procesi i rivlerësimit apo vendimi i dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit është marrë në shkelje serioze të procedurave, në kushtet kur subjekti ka ardhur në dijeni gjatë procesit mbi ecurinë e kërkesës së tij. Për rrjedhojë, pretendimi i subjekti të rivlerësimit qëndron vetëm *pjesërisht*. Pavarësisht se Komisioni nuk doli me vendim të ndërmjetëm për pranimin apo refuzimin e kërkesës së tij, ai ka ardhur në dijeni të mënyrës së adresimit të saj në rezultatet e hetimit administrativ, që nënkupton përpara marrjes së vendimit nga Komisioni. Si rrjedhojë, në dritën e kësaj analize, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasur në dispozicion të gjitha mjetet procedurale për të paraqitur kërkesa apo disponuar akte.

**11.3.** Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni duhet të disponojë me vendim të ndërmjetëm mbi pranueshmërinë e çdo prove të paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit. Kuadri kushtetues dhe ligjor që normon procesin e rivlerësimit dhe konkretisht neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 52 i ligjit nr. 84/2016, përcakton se subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të kryer nga Komisioni. Ligji nuk parashikon detyrimin e Komisionit që të shprehet me vendim të ndërmjetëm për çdo akt dhe dokument të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit. Paraqitja e atyre dokumenteve dhe akteve që subjekti vlerëson se mbështesin dhe plotësojnë mbrojtjen e tij, është në vlerësimin e vetë subjektit. Ndërkohë, referuar nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, detyrimi i Komisionit është t’i bëjë me dije subjektit të rivlerësimit çështjet për të cilat provat kanë nivelin e provueshmërisë. Është detyrë e subjektit të rivlerësimit të vlerësojë mënyrën se si ai do të realizojë mbrojtjen e tij, si dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë për të provuar të kundërtën për gjetjet që kanë rezultuar nga hetimi administrativ.

**12.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka cenuar parimin e *kontradiktoritetit* dhe të *barazisë së armëve*, pasi nuk është respektuar procedura e vlerësimit të provave të paraqitura sipas kërkesave të nenit 48 të K.Pr.Administrative, duke e kthyer seancën e datës 08.07.2019 në një seancë tërësisht formale. Subjekti i rivlerësimit argumenton se Komisioni ka administruar provat shpresore që ai ka paraqitur, por nuk rezulton t’i ketë analizuar ato e as ka arsyetuar në vendimin përfundimtar faktet që ato përmbajnë. Si rrjedhojë, ai është njohur me papërdorshmërinë e tyre vetëm nëpërmjet vendimit. Ky element cenon zhvillimin e një hetimi të plotë sipas neneve 45, 49, 50 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 14 të K.Pr.Civile, dhe e vendos subjektin në disavantazh e cenon standardet e detyrueshme që rrjedhin nga parimi i kontradiktorialitetit.

**12.1.** Në analizë të kronologjisë së zhvillimit të procesit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjektit të rivlerësimit i janë garantuar të drejtat për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, përfshirë edhe aspektet e parimit të kontradiktorialitetit, të barazisë së armëve, proporcionalitetit dhe ligjshmërisë. Konkretisht, Komisioni ka zhvilluar procesin e mbledhjes, verifikimit, analizës dhe shqyrtimit për të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin, përgjatë periudhës janar 2018 – qershor 2019. Nga aktet në fashikull, rezulton se ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit ka pasur komunikim të rregullt lidhur me dhënien e sqarimeve, informacionit dhe dokumentacionit provues. Subjekti i rivlerësimit është pyetur, i është dhënë e drejta të njohë aktet, ka ushtruar të

---

<sup>9</sup> Pika 8 e këtij akti përcakton që: “8. Brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës së subjektit për thirrjen e një dëshmitari apo marrjen e një prove, trupa gjykuese, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendos me arsyetim për pranimin apo refuzimin e kërkesës. Në rast se kjo kërkesë pranohet, relatori i çështjes ka detyrimin të marrë deklarinim/provën mbështetëse, ta vlerësojë atë dhe ta përfshijë në relacionin përfundimtar”.

drejtën e mbrojtjes duke dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumente dhe akte në cilësinë e provave dhe, së fundmi, është dëgjuar në seancën dëgjimore. Në përmbledhje të sa më sipër provon se subjektit të rivlerësimit i janë garantuar parimet dhe të drejtat për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Po ashtu, për qartësimin e rrethanave që lidheshin me pasurinë, Komisioni ka thirrur në cilësinë e dëshmitarëve një nga personat e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, ka administruar në dosje komunikimin dhe më tej zhvillimin e takimit me dëshmitarin sipas procesverbalit përkatës. Me anën e rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni e ka njoftuar subjektin mbi ecurinë e plotësimit të kërkesës së tij për thirrjen e dëshmitarëve, të artikuluar në përgjigjet e pyetësorëve. Subjekti i rivlerësimit është njohur me aktet dhe dokumentet e administruara nga Komisioni, çka e ka ndihmuar atë të paraqesë dokumentet plotësuese në përgjigje të barrës së provës. Po kështu, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit, të ketë parashtruar pretendime apo kërkesa për shkelje të procedurave nga ana e Komisionit, apo kërkesa të tjera me objekt specifik. Gjithashtu, konstatohet se një nga anëtarët e trupit gjykues ka kërkuar heqje dorë nga pjesëmarrja në gjykim, me qëllim shmangien e perceptimit se mund të favorizonte subjektin, për shkak të një marrëdhënieje të krijuar nga pozicioni i ushtrimit të profesionit të saj më herët dhe të detyrave të subjektit, bazuar në denoncimin e një qytetari, të ardhur në Komision.

**12.2.** Trupi gjykues vlerëson se fakti që në vendimin e Komisionit nuk janë cituar në mënyrë specifike të gjitha aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk nënkupton apo provon mungesë analize të akteve. Vendimi rezulton i bazuar në fakte që rrjedhin nga dokumentacioni i paraqitur gjatë procesit të hetimit, përfshirë edhe atë të sjellë nga subjekti. Përpos kësaj, deklaratat noteriale të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit, nëpërmjet të cilave kërkohet të provohen apo vërtetohen deklaratime të vetë subjektit, pavarësisht vlerës ligjore nga pikëpamja formale, në kontekstin e procesit të rivlerësimit, përbëjnë akte me vlerë të kufizuar, që në jurisprudencën tanimë të konsoliduar të Kolegjit janë vlerësuar si përpjekje për të justifikuar qëndrimin/deklarimet e subjektit gjatë procesit<sup>10</sup>. Analiza dhe vlerësimi i këtij pretendimi është trajtuar më tej edhe gjatë shqyrtimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me vlerësimin e pasurisë.

13. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka *paragykuar* çështjen duke mos marrë në konsideratë provat e paraqitura prej tij dhe e ka ftuar në seancë dëgjimore, ndërkohë që nuk e ka njoftuar lidhur me rezultatin përfundimtar të hetimit. Veprimet e Komisionit, për rrjedhojë, janë në kundërshtim me nenet 42, pika 1 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenet 45 dhe 55 të ligjit nr. 84/2016, nenet 48, 59 dhe 87, pika 2, germa “ç” e K.Pr.Administrative, si dhe në kundërshtim me pikat 10 dhe 11 të aktit “Hapat proceduralë të unifikuar për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, pasi subjekti duhet të kishte kohën e

---

<sup>10</sup> Shih paragrafët 35 dhe 36 në vendimin nr. 6/2018 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit B. N., dhe paragrafin 12.3 në vendimin nr. 11/2018 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit T. N., vendime të marra përpara vendimit objekt ankimi. Po ashtu, shih edhe paragrafin 85.2 në vendimin nr. 34/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. E. P., paragrafin 20.5 në vendimin nr. 2/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit B. C., paragrafin nr. 41.2 në vendimin nr. 5/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit A. D., paragrafin 26.2 në vendimin nr. 23/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. D. P., paragrafin 28.7 në vendimin nr. 26/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Ç. Sh, paragrafët 32.5 dhe 34.3 në vendimin nr. 29/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit E. A., paragrafin 20.5 në vendimin nr. 33/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit D. S., paragrafin 16.6 në vendimin nr. 36/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit Sh. C., paragrafët 57 dhe 75 në vendimin nr. 3/2021 që i përket subjektit të rivlerësimit E. H., paragrafin 102 në vendimin nr. 4/2021 që i përket subjektit të rivlerësimit E. B., paragrafët 22.5 dhe 26.2 të vendimit nr. 8/2021 që i përket subjektit të rivlerësimit I. M., paragrafin 20.2 në vendimin nr. 11/2021 që i përket subjektit të rivlerësimit P. K..

mjaftueshme për përgatitjen e nevojshme mbi rezultatet përfundimtare, duke ushtruar efektivisht të drejtën për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore. Subjekti sjell në vëmendje se, referuar nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjeve duhet të udhëhiqen nga parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, sikurse përcaktohet dhe në rekomandimin CM/Rec (2010/12) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

**13.1.** Nga shqyrtimi i të dhënave të dosjes, rezulton se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron. Pasi ka marrë rezultatet e hetimit administrativ, më datë 01.07.2019, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë edhe *përgjigjet*, shoqëruar me dokumentacionin përkatës; më datë 02.07.2019 është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore; më datë 04.07.2019 është dëgjuar në seancën dëgjimore dhe me datë 08.07.2019, Komisioni ka shpallur vendimin. Referuar kësaj kronologjie kohore, rezulton se seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit është zhvilluar 3 ditë pasi janë administruar shpjegimet dhe provat ose 2 ditë pasi anëtarët e trupit gjykues kanë dëgjuar relatimin e relatorit të çështjes mbi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me të tria kriteret – referuar procesverbalit të mbledhjes të datës 02.07.2019, ora 15:00.

**13.2.** Për rrjedhojë, rezulton që Komisioni ka zbatuar parashikimet e pikave 10 dhe 11 të aktit “Hapat proceduralë të unifikuar - për rivlerësimin e subjekteve nga trupat gjykuese të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”<sup>11</sup>. Siç përcaktohet në këto rregulla procedurale, relatori ka relatuar kur dosja ishte gati dhe afati për dorëzimin e provave dhe shpjegimeve me shkrim nga subjekti kishte përfunduar. Po atë ditë, trupi gjykues ka vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore dhe njoftimin e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, në vijim të të njëjtave parashikime, rezulton se është zhvilluar seanca dëgjimore dhe është vijuar më tej me përmbylljen e procesit dhe shpalljen e vendimit. Caktimi i datës së seancës dëgjimore është në diskrecion të Komisionit, për sa kohë është çmuar se ka mjaftueshëm elemente për të disponuar për vlerësimin e subjektit të rivlerësimit. Dispozitat ligjore nuk parashikojnë detyrim për Komisionin që të përcjellë një rezultat të dytë të hetimit pas marrjes së përgjigjeve dhe provave mbi rezultatet e hetimit administrativ të parë. Për më tepër, teorikisht, një procedurë e tillë mund të çonte në zgjatje të procesit pa limit kohor, gjë që do të cenonte qëllimin dhe efektivitetin e tij. Së fundmi, nga aktet procedurale në fashikull nuk rezulton që vetë subjekti gjatë seancës dëgjimore të ketë shprehur kërkesa e pretendime lidhur me kohën në dispozicion apo mbi shkeljet e mundshme të të drejtave të tij, sikurse pretendon në ankim.

**13.3.** Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të theksojë se parimi i proporcionalitetit dhe i objektivitetit, i sjellë në vëmendje nga subjekti në ankim, i referohet vlerësimit në tërësi të çështjes dhe synon që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Sipas vendimit, për shkak se problematikat e evidentuara në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe aftësive profesionale, janë të atilla që cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, Komisioni ka disponuar dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, në kushtet kur Komisioni ka konstatuar probleme në dy kriteret të procesit të rivlerësimit, të cilat, sipas arsytimit, kanë afektuar edhe

---

<sup>11</sup> Pika 10 parashikon: “Kur dosja është gati, pasi ka përfunduar edhe afati për dorëzimin e provave dhe shpjegimeve me shkrim nga subjekti, relatori përgatit relacionin përfundimtar dhe ia vë në dispozicion trupës dhe vëzhguesit ndërkombëtar”. Pika 11 parashikon: “Trupa, në mbledhjen e thirrur nga kryesuesi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, mund të vendosë për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore. Në këtë rast trupa vendos për njoftimin e subjektit, për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës dëgjimore. Afati për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t'u dëgjuar në seancë”.

besimin te publiku, argumentimi mbi parimin e proporcionalitetit duket i tejkaluar. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj dhe në fakte.

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *sjellja* e trupit gjykues të Komisionit nuk përmbush standardin e gjykimit të çështjes nga një *gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, si element thelbësor i procesit të rregullt ligjor, referuar jurisprudencës së GjEDNj-së në çështjen *Belilos* kundër Zvicrës.

14.1. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNj-së, në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanësisë, u është nënshtruar filtrave të analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias<sup>12</sup>, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese<sup>13</sup> dhe së fundmi është konfirmuar edhe nga shqyrtimi në praktikë nga GjEDNj-ja në vendimin që i përket *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë<sup>14</sup>. Në këtë të fundit, GjEDNj-ja nuk konstatoi shkelje të nenit 6 §1 të KEDNj-së lidhur me mënyrën e funksionit të Komisionit dhe Kolegjit. Në dritën e këtyre fakteve, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i mbështetur në ligj dhe nuk qëndron. Për rrjedhojë, parimet e trajtuara në praktikën e GjEDNj-së që ka sjellë në vëmendje subjekti i rivlerësimit, respektohen dhe garantojnë nëpërmjet ekzistencës dhe funksionimit të Kolegjit. Konkretisht, në çështjen e *Belilos*<sup>15</sup>, GjEDNj-ja theksoi rëndësinë që ka rishikimi nga një gjykatë i çështjeve për shkaqe të faktit dhe ligjit, si garanci e respektimit të procesit të rregullt. Në kushtet kur vendimi i Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit të hollësishëm nga ana e Kolegjit, garancitë për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim efektiv dhe të paanshëm, adresohen nga Kolegji. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në ligj.

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka paragjykuar çështjen, ka paracaktuar vendimin dhe ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, duke përfituar nga statusi i dyfishtë – organ hetues dhe gjykatë. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se *edhe* ky pretendim i subjektit lidhet me funksionimin dhe organizimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, në kontekstin e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, dhe jo me veprime të Komisionit që lidhen me rivlerësimin e subjektit individualisht. Edhe ky aspekt i funksionimit të procesit të rivlerësimit nëpërmjet organeve që e kryejnë atë, është analizuar dhe gjetur në përputhje me të gjitha garancitë e nevojshme për zhvillimin dhe respektimin e një procesi të rregullt ligjor nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 – paragrafët 38 dhe 67<sup>16</sup> – dhe Komisioni i Venecias<sup>17</sup>. Pretendimi i subjektit për cenim të parimit të paanësisë dhe, për rrjedhojë, të procesit të rregullt ligjor, për shkak se e njëjta trupë gjykimi heton dhe vendos, është i pabazuar. Edhe në vendimin e GEDNj-së që i përket *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* – paragrafët 307 dhe 308 – është konstatuar se mënyra se si funksionojnë institucionet e rivlerësimit përmbush standardet e KEDNj-së, është gjetur e drejtë<sup>18</sup>. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk qëndron pasi nuk gjendet i mbështetur në ligj.

16. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar nën doza të larta *paragjykimi* dhe në shkelje të parimit të prezumimit të *pafajësisë*, çka ka ndikuar në humbjen e ekuilibrit përgjatë

<sup>12</sup> [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

<sup>13</sup> *Shih vendimet nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017* - [http://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php)

<sup>14</sup> § <http://hudoc.echr.coe.int/eng/?i=001-208053>.

<sup>15</sup> <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:%5B%22001-57434%22%7D>

<sup>16</sup> [http://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php).

<sup>17</sup> [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

<sup>18</sup> <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22tabview%22:%5B%22document%22,%22itemid%22:%5B%22001-208053%22%7D>.

vlerësimit të subjektit të rivlerësimit. Nga shqyrtimi i akteve të administruara, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidenton të dhëna se vendimi ka qenë i paracaktuar apo i paragykuar. Përpos kësaj, vetë subjekti nuk shpjegon dhe nuk shtjellon se çfarë e motivon sipas tij këtë lloj sjelljeje të Komisionit. Nga ana tjetër, procesi i rivlerësimit është tërësisht administrativ dhe kryhet mbi parimet e parashikuara në ligjin nr. 84/2016 dhe, kur është rasti, mund të zbatohen edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin për gjykatat administrative. Ndërkohë që shkelja e parimit të prezumimit të pafajësisë është një parim i procesit penal, çka nuk gjen zbatim dhe mbështetje në këtë proces. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk qëndron pasi nuk gjendet i mbështetur në ligj.

17. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka shkëlur parimin e gjykimit nga një *gjykatë e paanshme*. Mosnjohja e tij me anëtarët e trupit gjykues dhe e këshilltarëve në kohë reale, që më datë 15.01.2018, e ka vënë subjektin në pamundësi objektive për verifikimin dhe shqyrtimin eventual të pretendimit për ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarin e trupës gjyquese, znj. F. Sh.. Subjekti i rivlerësimit nuk është njoftuar me dorëheqjen e komisioneres F. Sh. më datë 29.10.2018 – 10 muaj pasi ishte hedhur shorti për caktimin e anëtarëve të trupit gjykues (15.01.2018) apo procedurës së ndjekur për ndryshimin e trupit gjykues. Subjekti shprehet se pretendimi se ndaj saj, në cilësinë e noterës, ka pasur një kallëzim penal në vitin 2006, që ka përbërë shkak për dorëheqjen, nuk është i vërtetë. Sipas subjektit, Komisioni është i detyruar të zbatojë detyrimet e parashikuara nga KEDNj-ja në veçanti, nenet 6 dhe 8, dhe se kufizimet, duhet të jenë në përputhje me parashikimet e nenit 17 të Kushtetutës e nuk mund të tejkalohen.

17.1. Nga shqyrtimi i akteve të administruara, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit është njoftuar mbi përbërjen e trupit gjykues më datë 06.06.2018. Nga korrespondenca elektronike e datës 15.10.2018 konstatohet se ai ka marrë dijeni mbi emrat e anëtarëve më së paku në këtë datë. Po kështu, më datë 21.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar marrjen e rezultateve të hetimit administrativ, në përmbajtje të së cilave pasqyrohej edhe përbërja e trupit gjykues, pjesë e të cilit tashmë ishte anëtari zëvendësues. Më 02.07.2019, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar marrjen dijeni dhe prezencën e tij në seancën dëgjimore, duke qenë plotësisht në dijeni të përbërjes së trupit gjykues, element përbërës i njoftimit. Nga shqyrtimi i procesverbalit, vërehet se në fillim të seancës dëgjimore, është bërë prezantimi i trupit gjykues dhe subjekti i rivlerësimit as gjatë parashtrimit të pretendimeve të tij dhe as në fjalën përfundimtare nuk ka shprehur kërkesa apo pretendime lidhur me zëvendësimin e anëtares, znj. Sh., apo të ketë kërkuar informacion për stafin mbështetës të Komisionit për të verifikuar ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi, sikurse ai pretendon. Përkundrazi, konstatohet se subjekti ka shprehur nota falënderuese për Komisionin: *për hetimin e kryer, për çdo gjë që kanë administruar, çdo gjë që kanë bërë në verifikim të saktë, të plotë dhe të gjithanshëm administrativ*. Pra, subjekti, pavarësisht se ishte në dijeni të së drejtës për të deklaruar konfliktin e mundshëm të interesit me ndonjë prej anëtarëve, nuk rezulton të ketë kryer një deklaram të tillë. Asnjëherë gjatë procesit, subjekti nuk rezulton të ketë ngritur pretendime të tilla, përfshirë edhe gjatë seancës dëgjimore të datës 04.07.2019.

17.2. Në dosjen e Komisionit janë administruar deklaratat mbi konfliktin e interesit të anëtarëve të trupit gjykues, ndërkohë që nuk gjendet asnjë akt apo kërkesë e subjektit mbi ndonjë gjendje të mundshme të konfliktit të interesit me ndonjë prej anëtarëve, përfshirë edhe me komisioneren, znj. Sh.. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për pamundësi objektive për të verifikuar dhe shqyrtuar ekzistencën e konfliktit të interesit me komisioneren, znj. Sh., është i pambështetur. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mungesën e komunikimit të këshilltarëve të trupit gjykues,

me qëllim verifikimin e ekzistencës së mundshme të konfliktit të interesit, është i pakuptimtë dhe i pabazuar, pasi këshilltarët janë pjesë e strukturës ndihmëse të komisionerëve dhe nuk kanë kompetenca vendimmarrëse, çka përjashton mundësinë e konfliktit të interesit, në kuptim të ligjit nr. 9367/2005<sup>19</sup>. Vendimi për pranimin e kërkesës së dorëheqjes të znj. Sh., i datës 29.10.2018, nuk parashikon komunikimin e këtij vendimi subjektit të rivlerësimit. Në përmbajtjen e vendimit jepen arsyet e kërkesës dhe arsyetimi ligjor i trupit gjykues për pranimin e kërkesës. Kontestimi i arsyeve mbi të cilat bazohet kërkesa e komisioneres për të hequr dorë është i panevojshëm, në kushtet kur ato janë vlerësuar dhe pranuar nga trupi gjykues i krijuar për këtë qëllim. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të ushtronte të drejtën për njohjen me aktet e dosjes, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, sikurse e ka ushtruar më datë 24.06.2019, apo të njëjti me këtë vendim më herët sesa data kur kjo ka ndodhur me kërkesën e tij, më datë 08.10.2019. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku ankimi për cenueshmëri të vendimit të Komisionit. Për më tepër, ndaj këtij vendimi të Komisionit, nuk parashikohet asnjë mjet ligjor kundërshtimi për subjektin e rivlerësimit.

**17.3.** Nga ana tjetër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka trajtuar konkretisht në ankim se në çfarë forme apo në çfarë mënyre vendimi i Komisionit bie ndesh me garancitë e neneve 6 dhe 8 të KEDNj-së, ashtu si edhe nuk arsyeton se pse kufizimet janë në shkelje të parashikimeve të nenit 17<sup>20</sup> të Kushtetutës. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, kufizimi pjesërisht i të drejtave të subjekteve të rivlerësimit që lidhen me respektimin e jetës private dhe me barrën e provës, është ngritur në nivel kushtetues dhe i trajtuar specifikisht në nenin A të Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, institucionet e rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin, kanë detyrimin e respektimit të jetës private të subjekteve në masën që diktohet nga ky parashikim i ri kushtetues.

- 18.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka shkelur parimin e barazisë para ligjit, të mosdiskriminimit dhe, për rrjedhojë, edhe të sigurisë juridike, pasi e ka trajtuar subjektin e rivlerësimit në mënyrë të diferencuar, duke qenë se për situata të njëjta objektive me subjekte të tjera ka dhënë vendime konfirmimi, në ndryshim prej rastit të tij. Subjekti i rivlerësimit u është referuar disa vendimeve të Komisionit – kryesisht vendime nëpërmjet të cilave janë konfirmuar nga Komisioni subjekte të tjera<sup>21</sup> – një pjesë e të cilave i janë bashkëlidhur ankimit – për të mbështetur pretendimin e tij për zbatimin e standardeve të dyfishta nga ana e Komisionit. Me përjashtim të vendimit të Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Z. (vendim i cili u ndryshua nga Kolegji), vendimet e tjera, të referuara nga subjekti i rivlerësimit, nuk i janë nënshtruar kontrollit nga Kolegji. Për rrjedhojë, analiza e këtij pretendimi mund të vlerësohet në nivel parimor, kryesisht në kuadër të garancive që ofron funksionimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili ka tagër të shërojë çdo cedim të mundshëm procedural nga Komisioni. Kjo garanci

---

<sup>19</sup> Neni 4 i ligjit parashikon se: “2. Për qëllimet e këtij ligji: a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit; b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit; c) një zyrtar” ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave “a” ose “b” të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.”

<sup>20</sup> Neni 17 i Kushtetutës përcakton: “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

<sup>21</sup> Subjekti u është referuar vendimeve të Komisionit që kanë konfirmuar në detyrë subjektet e rivlerësimit Xh. Z., I. T., F. M., A. K., A. D., K. B. dhe E. N.



adreson dhe rëndësinë e nënvizuar nga jurisprudenca e GjEDNj-së për krijimin e mekanizmave që mund të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudencës<sup>22</sup>, e cila duhet t'i shërbejë Komisionit për të mbajtur qëndrime konsistente në interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit të rivlerësimit, mbi bazën e provave dhe rrethanave konkrete<sup>23</sup>. Sikurse Kolegji është shprehur edhe më herët në shqyrtimin e pretendimeve të kësaj natyre të parashtuara nga subjekte të tjera<sup>24</sup>, është me rëndësi të theksohet se vlerësimi i subjekteve të rivlerësimit që kanë kryer të njëjtat shkelje, në kontekstin e parimit të barazisë para ligjit, duhet të mbështetet në specifikat dhe rrethanat që kanë sjellë shkeljen e kryer, duke shmangur vlerësime të ndryshme për të njëjtat specifika dhe rrethana.

19. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi është tërësisht *alogjik* sepse konkluzioni për vlerësimin e pasurisë nuk qëndron në raport me *figurën, moralin dhe aftësitë profesionale* të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i subjektit është adresuar tashmë gjerësisht nga jurisprudenca e Kolegjit, në të cilin është theksuar se çdo kriter vlerësimi ka peshën dhe rëndësinë e tij specifike dhe të pavarur nga të tjerët, çka do të thotë që pavarësisht rezultatit pozitiv në një apo dy kritere, nëse subjekti i rivlerësimit cedon në kriterin e tretë, ndaj tij aplikohet automatikisht masa e shkarkimit nga detyra. Ky prezumim sanksionohet qartësisht në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohet se konfirmimi në detyrë jepet nëse plotësohen në mënyrë kumulative vlerësime pozitive për të tria kriteret: nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel i besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Për rrjedhojë, ky pretendim gjendet i pabazuar.
20. Subjekti i rivlerësimit parashtron se në pikën 11 të vendimit, Komisioni shprehet se procesi i rivlerësimit përfundoi për 2 kritere, ndërkohë që sikurse është përmendur në pikën 7 të tij, vlerësimi është kryer për të tre komponentët. Nga një lexim i thjeshtë i vendimit, konstatohet se në paragrafin 11, Komisioni është shprehur se: “Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, [...], trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Agolli, bazuar në dy komponentë, atë të vlerësimit të pasurisë dhe të aftësive profesionale”. Ndërkohë që nga shqyrtimi i akteve të administruara rezulton se procesi i rivlerësimit për subjektin u zhvillua për verifikimin e të tria kritereve: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale dhe rezultati për secilin kriter gjen pasqyrim në tekstin e vendimit. Gjendur në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se kjo shprehje e Komisionit përbën një lapsus apo gabim në të shprehur, të karakterit material, dhe nuk mund të konsiderohet shkak i atillë që cenon vendimin e dhënë.
21. Në përfundim të analizës së pretendimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për shkelje të parimeve procedurale, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton veprime apo mosveprime të Komisionit të cilat të kenë cenuar të drejtat e subjektit për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, në vijim edhe të sa është shtjelluar më sipër, nuk rezultojnë kushtet e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 që do të diktonin shqyrtimin në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit, parë edhe nga këndvështrimi procedural. Për rrjedhojë, trupi gjykues vijoi shqyrtimin e shkaqeve të parashtuara në ankim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi pa praninë e palëve.

---

<sup>22</sup> *Shih Beian k. Romania (no. 1)*, §§ 37 dhe 39; *Lupeni Greek Catholic Parish and Others k. Romania [GC]*, §§ 116-35).

<sup>23</sup> *Shih vendimin nr. 71, datë 02.12.1998, të Gjykatës Kushtetuese*:  
[http://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php).

<sup>24</sup> Paragrafi 21.2 i vendimit nr. 1/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. A. S..

C. *Shkaqet në ankim që lidhen me vlerësimin e pasurisë*

22. Në vijim të këtij arsytimi, shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë janë trajtuar në dy drejtime, bazuar në tematikën e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit: çështjet që lidhen me interpretimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 3, pika 19, 30, 32, pikat 1 dhe 4, 33, pika 5 dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 në rrethanat faktike të çështjes së tij, si dhe pretendime lidhur me saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të tij dhe të ligjshmërisë së burimit për krijimin e pasurisë së paluajtshme apartament, të ndodhur në Gjirokastrë.

a) *Për sa u përket pretendimeve për kuptimin dhe interpretimin e kuadrit kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit të kriterit të pasurisë në raport me faktet e çështjes së tij, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

23. Subjekti i rivlerësimit parashtron se problematika e konstatuar lidhet me të vetmen pasuri të paluajtshme që ka në pronësi familja e tij – një apartament banimi me sipërfaqe 68,5 m<sup>2</sup> në Gjirokastrë – të ndërtuar në vitet '80, blerë në vlerën 3.000.000 lekë, sipas kontratës së shitjes së datës 20.06.2007. Ai nuk gjendet në kushtet e më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme, e ka dorëzuar deklaratën *vetting* brenda afatit ligjor dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë. Në mënyrë të përmbledhur, më tej, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk mund të shkarkohet nga detyra për shkelje në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer deklarime të sakta, të cilat përjashtojnë rrezikun e të gjendurit në situatën e fshehjes së pasurisë apo deklarimit të rremë sipas ligjit nr. 84/2016; mungesa e burimeve financiare të ligjshme mund të përbëjë deklarim të pamjaftueshëm vetëm nëse është në nivel të rëndë, të krahasuar ose të barabartë me fshehjen e pasurisë, deklarimin e rremë ose situatën e konfliktit të interesit. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë konkluzionet ndër vite të një organi të specializuar si ILDKPKI-ja, nuk ka dhënë argumente kundër dhe ka kryer një vlerësim jo të drejtë mbi faktet dhe provat e administruara dhe të shqyrtuara, duke arritur në konkluzione të hamendësuar; nuk plotësohet kushti i dytë kumulativ – ai i deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës; sjellja duhet të jetë në të njëjtin nivel kundërligjshmërie sikurse janë shkeljet e parashikuara në pikat 1, 2, 4 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016; është cenuar parimi i barazisë përpara ligjit pasi është trajtuar me standarde të ndryshme nga subjektet e tjera, referuar arsytimit të Komisionit në vendimet që u përkasën subjekteve të rivlerësimit Xh. Z. dhe A D.; besueshmëria për ligjshmërinë e krijimit të pasurisë bazohet në fakte, prova dhe në parashikimet e ligjit; qëllimi i parashikimeve kushtetuese e ligjore dhe fryma e procesit të rivlerësimit nuk është penalizimi për shkak të pasaktësive të kryera pa qëllim dashakeq dhe që nuk sjellin pasoja, por të penalizohen deklarime të pavërteta të kryera me qëllim për të fshehur pasurinë. Lidhur me këto pretendime, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

23.1. Së pari, dhe në vijim të analizës së kryer më sipër – në paragrafët e seksionit B të këtij vendimi – Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar lidhur me interpretimin dhe zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, formulimi i të cilit për deklarimin e pamjaftueshëm të pasurisë konkretizon përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Procesi i vlerësimit të kriterit të pasurisë zbërthehet në nenet 30–33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përcaktojnë parimet dhe mënyrën e verifikimit të përmbushjes së detyrimeve të subjektit të rivlerësimit për të kryer deklarim të saktë, për të provuar burimet e mjaftueshme financiare të ligjshme dhe mungesën e konfliktit të interesit. Po kështu, në këto dispozita përcaktohet edhe vendi që zë raportin e kontrollit të kryer nga ana e ILDKPKI-së në raport me vlerësimin përfundimtar të procesit të rivlerësimit të kryer nga institucionet e rivlerësimit, e shprehur qartësisht nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017

dhe në Opinionin e Komisionit të Venecias. Po kështu, referuar edhe arsytimit të vendimit të Kolegjit që ndryshoi vendimin e Komisionit për njërin nga subjektet e përmendura në ankim [vendimi nr. 19/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Z.<sup>25</sup>], saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi apo në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur janë elemente përcaktuese për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë.

**23.2.** Së dyti, nga leximi logjik i ligjit, rezulton që legjislatori ka zgjedhur formulimin alternativ, duke u dhënë të njëjtën peshë shkeljeve për shkaqe të veçanta. Vërtetimi i secilit prej këtyre shkaqeve *autonome*, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit shkon në favor të prezumimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Deklarimi i pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, rregullohet në një nen të posaçëm të Aneksit të Kushtetutës, sikurse neni Dh, dhe formulimi i pikës 3 të nenit 61 për deklarimin e pamjaftueshëm të kontrollit të figurës zbërthen pikërisht përcaktimet e këtij neni. Pavarësisht se deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë dhe figurës janë përmbledhur në normimin ligjor të pikës 3 të nenit 61, bazuar në përcaktimin e qartë që jep Aneksi i Kushtetutës për këto dy kritere, nuk mund të pretendohet se aplikimi i tyre duhet të interpretohet në mënyrë kumulative. Në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, këto dy kritere nuk kërkojnë demos praninë e njëra-tjetrës për t'u vërtetuar deklarimi i pamjaftueshëm. Kjo do të thotë se subjektet e rivlerësimit duhet të shpjegojnë bindshëm se nuk gjenden në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, nuk kanë kontakte të papërshtatshme, nuk kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm të vlerësimit të pasurisë, nuk kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm të kontrollit të figurës, janë të aftë profesionalisht, dhe që me sjelljet dhe veprimet e tyre nuk kanë cenuar besimin e publikut të drejtësisë. Për rrjedhojë, shkeljet e dispozitave që lidhen me deklarimin e pamjaftueshëm të pasurisë sipas ligjit kanë të njëjtën peshë sikurse shkeljet për kriteret e tjera të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016.

**23.3.** Së treti, vlerësimi i subjekteve të rivlerësimit që kanë kryer të njëjtat shkelje, në kontekstin e parimit të barazisë para ligjit, duhet të mbështetet në specifikat dhe rrethanat që kanë sjellë shkeljen e kryer, duke shmangur vlerësime të ndryshme për të njëjtat specifika dhe rrethana. Në kontekst të qëllimit të procesit të rivlerësimit, pasaktësitë në deklarime vlerësohen në raport me analizën e përgjithshme të kriterit të vlerësimit të pasurisë<sup>26</sup>. Nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit, konstatohet se aplikimi i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit nuk rezulton të jetë derivat vetëm i pasaktësive në deklarime për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sikurse e paraqet subjekti i rivlerësimit. Gjithsesi, këto pretendime gjenden të trajtuara gjerësisht edhe në analizën që u janë bërë shkaqeve të ankimit, në paragrafët e mëposhtëm të këtij vendimi.

*b) Për sa u përket pretendimeve për saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve dhe të ligjshmërisë së burimit për krijimin e pasurisë së paluajtshme të apartamentit, të ndodhur në Gjirokastër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

- 24.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se mosdeklarimi i huas në vlerën 3.000.000 lekë, të marrë nga z. N. Dh., në deklaratën *vetting*, si burim krijimi i kësaj pasurie, ka ndodhur pasi ishte një hua e marrë për një afat të shkurtër me qëllim përfundimin e procedurave të kredisë; për shkak të kohës që ka

<sup>25</sup> [http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh\\_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralet.pdf](http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-Zh_Zaganjori-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralet.pdf)

<sup>26</sup> <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/12/Vendimi-i-Anonimizuar-subjekti-T.-Ndreca.pdf>

kaluar, subjekti pretendon se gabimet i atribuohen harresës – vetëm kur Komisioni e ka njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka rikujtuar rrethanat.

**24.1.** Subjekti i rivlerësimit argumenton se nuk e konsideron huan burim të krijimit të apartamentit, përndryshe do kishte aplikuar në bankë për kredi për shlyerje huaje e jo për blerje apartamenti banimi; ka deklaruar me vërtetësi në deklaratën e pasurisë se 12 vjet më herët kishte nevojë të blinte një apartament banimi. Subjekti shtjellon kronologjinë kohore të veprimeve të ndërmarra që, sipas tij, ishin si vijojnë: rënia dakord me shitësin që çmimi do të paguhej sapo të lëvrohej kredia [deklarata e datës 08.06.2007]; aplikimi për kredi për shtëpi pranë bankës [datë 06.06.2007]; banka ka kryer inspektimin e pronës [datë 12.06.2007] dhe raportin për vlerësimin e saj [datë 14.06.2007]; shitësi nuk pranoi të nënshkruante kontratën e shitblerjes pa marrë lekët *cash* në dorë [datë 20.06.2007]; është informuar nga banka se nuk mund të merrte kredi pa hipotekuar një pasuri si garanci; bashkëshorti i drejtoreshës së bankës, z. N. Dh., e ka ndihmuar nëpërmjet huas, në shumën 3.000.000 lekë [datë 20.06.2007]; është nënshkruar kontrata e shitblerjes, shlyer pagesa dhe kryer regjistrimi i pasurisë në emër të tij në ZVRPP Gjirokastër [datë 20.06.2007]. Huaja nga z. Dh. dhe mënyra e shlyerjes së saj janë dokumentuar [datë 21.06.2007]; ka marrë certifikatën e pronës në emër të tij [datë 21.06.2007]; është depozituar në bankë certifikata për lëvrimin e kredisë [datë 22.06.2007]; është disbursuar kredia nga banka [më datë 25.06.2007]; i është kthyer huaja huadhënësit, z. Dh., në *cash* [më datë 25.06.2007].

**24.2.** Saktësimi i datave që i përkasin një periudhe të largët nuk përbën ndryshim deklarimi apo deklarim kontradiktor, parashtron subjekti. Deklarimi në deklaratën *vetting* se çmimi i shitjes është likuiduar ditën kur është lëvruar kredia, është lapsus i paqëllimshëm. Ligjërisht është bërë pronar i pasurisë ditën kur është nënshkruar kontrata e shitjes dhe është likuiduar pagesa me huan e marrë nga z. Dh. [datë 20.06.2007] dhe po në të njëjtën datë janë kryer edhe procedurat pranë ZVRPP Gjirokastër; ka shpjeguar bindshëm qëllimin e marrjes së huas, në shumën 3.000.000 lekë – për t'i shlyer pagesën shitësit dhe konkluduar shitjen, provuar nga deklarata noteriale e z. B., bashkëlidhur ankimit. Dhënia e huas ka qenë një veprim i motivuar nga dashamirësia, pa asnjë interes. Huaja është shlyer në krye të 5 ditëve kalendarike 20.06.2007 – 25.06.2007, e konfirmuar edhe nga huadhënësi me deklaratën noteriale të paraqitur gjatë procesit në Komision [më datë 27.06.2019]. Dëshmia e znj. R. Dh., në cilësinë e drejtueses së bankës, nevojitet për të konfirmuar që banka nuk jepte kredi pa hipotekuar një pasuri si garanci. Edhe shitësi ka lëshuar një deklaratë noteriale dhe është i gatshëm të dëshmojë për të konfirmuar rrjedhën e ngjarjeve të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pagesën më datë 20.06.2007, të vlerës së mandatit prej 1% për procedurat e regjistrimit pranë ZVRPP Gjirokastër, si dhe paraqitjen para noteres F. Sh..

**24.3.** Në përfundim të parashtrimeve për këtë çështje, subjekti pretendon se Komisioni duhet të merrte dëshminë e komisioneres F. Sh., e cila, në cilësinë e noteres, në vitin 2007, ka ndjekur procedurat e bisedimeve për lidhjen e kontratës së shitjes dhe ishte në dijeni të plotë të bisedimeve mes palëve, hezitimit të shitësit për të nënshkruar kontratën pa marrë paratë *cash*, mënyrën e sigurimit të shumës nga blerësi, deri në konkludimin e nënshkrimit të kontratës. Në vijim të parashtrimeve për këtë çështje, subjekti i rivlerësimit kërkon riçeljen e hetimit për të thirrur në cilësinë e dëshmitares, znj. F. Sh.. Në plotësim të argumenteve, subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar pjesë nga arsyetimet e vendimeve të Komisionit që u përkasin subjekteve të rivlerësimit I. T. dhe F. M..

**24.4.** Komisioni ka konkluduar në vendim se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm dhe të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me burimin e ligjshëm që ka

shërbyer për blerjen e apartamentit dhe se i ka dhënë Komisionit përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me huan e marrë nga z. N. Dh.. Shpjegimet e subjektit janë në nivel deklarativ. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar se huaja është marrë në datën 20.6.2007 dhe se ajo i është dhënë z. V. B., ndërkohë që nga kontrata e blerjes së apartamentit, rezulton se pagesa do të bëhej *pas* marrjes së kredisë. Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Gjirokastër, apartamenti është regjistruar që në datën 20.6.2007, pa pritur likuidimin e çmimit të blerjes, sikundër parashikohet në kontratë. Nëse merren për bazë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, huaja nga z. Dh. përbën burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit dhe, si e tillë, duhej të deklarohet në deklaratën *vetting*.

**24.5.** Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se:

- Në datën 08.06.2007, z. V. B. ka nënshkruar një deklaratë noteriale [nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.], sipas së cilës deklaroi se ka kryer bisedime paraprake me z. Alfred Agolli për t'i shitur këtij të fundit apartamentin në pronësi të tij [z. B.], sapo të lëvrohet kredia në favor të z. Agolli. Sipas deklaratës, ky veprim pritej të ndodhte brenda 15 ditësh dhe se kjo deklaratë bëhej për efekt kredie bankare.
- Në datat 13.06.2007 dhe 14.06.2007, janë hartuar raportet nga banka për apartamentin në fjalë [në pronësi të z. V. B. dhe klient Alfred Agolli].
- Në datën 20.06.2007, është nënshkruar kontrata e shitjes [nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.] me palë shitëse V. B. dhe palë blerëse Alfred Agolli, me objekt: apartament banimi me sipërfaqe 68,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastër, ku parashikohet se çmimi i shitjes është 3.000.000 lekë dhe se do të likuidohet nga blerësi pasi të akordohet një kredi nga Raiffeisen Bank.
- Në datën 20.06.2007, është aplikuar pranë ZVRPP Gjirokastër – procedurë kjo e konfirmuar nga shkresat e datave 26.10.2018 [nr. {\*\*\*} prot.]<sup>27</sup> dhe 18.09.2017<sup>28</sup> të këtij institucioni.
- Në datën 21.06.2007, është nënshkruar një deklaratë noteriale me deklarues N. Dh. e Alfred Agolli, sipas së cilës Alfred Agolli i ka një detyrim prej 3.000.000 lekësh z. N. Dh., të cilin do t'ia shlyejë sapo t'i lëvrohet kredia nga Banka Raiffeisen. Në deklaratë citohet se shlyerja e huas do të bëhet me kalimin e fondeve në llogarinë bankare të z. Dh., pranë Raiffeisen Bank.
- Në datën 22.06.2007, është nënshkruar kontrata e kredisë bankare [nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.] – me palë kredidhënëse Raiffeisen Bank, kredimarrës Alfred Agolli, me objekt disbursimin e kredisë për blerje apartamenti, në shumën 2.850.000 lekë. Sipas kontratës për sigurimin e kredisë (neni 9), hipotekuesi ka vendosur si garanci pasurinë apartament banimi [me detajet përkatëse].
- Në datën 25.06.2007, në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit është disbursuar kredia në shumën 2.850.000 lekë. Po atë ditë, subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij bankare shumën prej 3.000.000 lekësh.

Nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite dhe gjatë procesit të rivlerësimit, konstatohet se:

- Në deklaratën e interesave private për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e apartamentit të banimit me sip. 68,5 m<sup>2</sup>, në vlerën 3.000.000 lekë dhe kredinë nga Raiffeisen

<sup>27</sup> Regjistruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2018.

<sup>28</sup> Praktikë e administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

Bank, në datën 22.06.2007, në rubrikën e detyrimeve financiare. Në këtë deklaratë nuk rezulton e deklaruar huaja e marrë te z. Dh.

- Në deklaratat e interesave privatë për vitet 2008 - 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e kredisë, në shumën respektive për secilin vit.
- Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e plotë të kredisë të marrë më datë 22.06.2007, sipas datës së kontratës.
- Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e kredisë në Raiffeisen Bank më datë 22.06.2007, në shumën 2.850.000 lekë, afatin [300 muaj] dhe qëllimin. Më tej, subjekti deklaroi blerjen e banesës nga z. V. B. më datë 20.06.2007, me detajet e referencës së kontratës së shitjes, çmimin [3.000.000 lekë] dhe deklaruar që pagesa është shlyer më datë 22.06.2007.
- Për herë të parë, në përgjigjet e pyetësorit të datës 24.05.2018, lidhur me pagesën e kryer për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shitësi ka kërkuar pagesën e plotë të çmimit të pasurisë për të kryer kalimin e pronësisë, ndërsa banka ndërkohë kërkonte garanci një pasuri për dhënien e kredisë. Sipas subjektit, si garanci do të ishte apartamenti që subjekti do të blinte, rrethanë kjo për të cilën V. B. nuk pranoi të konkludonte shitjen “pa marrë lekët paraprakisht”. Sipas subjektit, znj. R. Dh., ka ofruar ta ndihmonte duke tërhequr shumën në vlerën e apartamentit nga llogaria e bashkëshortit të saj [N. Dh.] për të shlyer pagesën me z. B., ndërsa kredia në vlerën 2.850.000 lekë “do kalonte direkt në llogarinë e saj”. Subjekti po ashtu ka deklaruar: *[...] më datë 21.06.2007, paradite, shitësi V. B. ka marrë 3.000.000 lekë nga N. Dh., veprim i kryer në ambientet e zyrës së drejtoreshës së Raiffeisen Bank, znj. R. Dh. [...]. Të nesërmen, më datë 22.06.2007 [...] më ishte çelur kredia në shumën 2.850.000 [...], e cila ka kaluar direkt në llogarinë e shtetasit N. Dh., njëkohësisht [...] i kam dhënë në dorë po atë ditë shumën prej 150.000 lekësh [...].*
- Në përgjigjet e pyetësorit të datës 15.10.2018, lidhur me arsyen e marrjes së huas nga z. Dh., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *[...] shumën prej tre milionë lekësh ia mora shtetasit N. Dh. dhe ia dhashë shtetasit V. B., veprim i kryer në zyrën e drejtoreshës së Raiffeisen Bank, znj. R. Dh. [...].* Më tej, për sa i përket momentit kur është marrë dhe destinacionit të huas, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: *[...] Huaja është përdorur që mua të më çelej kredia. Nuk e konsideroj që shtëpinë e kam blerë me huan që më ka dhënë z. N. Dh. [...] Pra, burimi i të ardhurave për blerjen e banesës është kredia bankare dhe jo huaja [...].* Në vijim, subjekti i rivlerësimit është shprehur edhe që: *[...] Huaja i është kthyer z. N. Dh. ditën që kam tërhequr shumën prej tre milionë lekësh në Raiffeisen Bank. [...] kredia bankare është disbursuar më datë 22.06.2017 [...] nuk e kam tërhequr atë ditë por pas dy ditësh, pasi ishin ditë pushimi [...].* Ndërsa sa i përket momentit të shlyerjes së pagesës për apartamentin, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur: *[...] Pagesën e apartamentit e kam kryer ditën që kemi lidhur kontratën e shitjes, nuk disponoj dokumentacion provues, përveç kontratës së shitjes [...].*
- Më datë 07.02.2019, Komisioni ka dëgjuar dëshminë e saj znj. R. Dh.. Dëshmitarja ka konfirmuar se huaja është dhënë *cash*, nga bashkëshorti i saj. Për sa i përket arsyes së mospritjes së procedurave bankare, znj. Dh. është përgjigjur se: *[...] duke qenë se nuk pranonte V. B., nëse ai nuk pranonte, nuk bëhej disbursimi [...] Ai donte që paratë t'i merrte cash. Nëse nuk i merrte cash, nuk jepte certifikatën e pronësisë. Nëse nuk bëhej certifikata e pronës, unë si bankë nuk e disbursoja dot [...].*
- Në përgjigje të rezultateve të hetimit, përkundër konstatimit që huaja nga z. Dh. nuk ishte deklaruar në deklaratën *vetting* apo si burim për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar, siç është përmbledhur më sipër në paragrafin 24.2, që huadhënia ishte për ta ndihmuar për nevoja të ngutshme, pasi ishte një moment i paparashikuar nga ana e tij dhe

procesi zgjati 5 ditë – nga data 20.06.2007 - 25.06.2007 – derisa atij t’i disbursohej kredia dhe që ai vetë konsideron kredinë si burim të krijimit të apartamentit, siç dëshmon dokumentacioni. Heshtja mbi këtë hua në deklaratën *vetting* ka qenë për shkak se u përkiste pak ditëve [nga data 20.06.2007 deri më datë 25.06.2007], të cilat përfshinin edhe ditë pushimi. Ka qenë një veprim i ndodhur para 12 vjetësh dhe “kujtesa e harresa bëjnë të vetën”.

- Gjatë procesit të rivlerësimit – në datën 27.06.2019 – z. N. Dh. ka nënshkruar deklaratën noteriale [nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol.], sipas së cilës deklaroi se Alfred Agolli e ka shlyer detyrimin prej 3.000.000 lekësh dhe nuk ka më asnjë detyrim të mbetur ndaj tij – në referencë të deklaratës noteriale të datës 21.06.2007; kjo shumë i është dhënë hua *cash* në dorë, z. Agolli në datën 20.06.2007 dhe është shlyer prej tij po *cash* në dorë në datën 25.06.2007; shlyerja *cash* në dorë është kryer me dëshirën e z. Dh.. Ai gjithashtu deklaroi se shumica e dhënë hua e ka burimin nga të ardhurat familjare dhe aktiviteti tregtar.

**24.6.** Në analizë të përmbajtjes së dokumentacionit të sipërcituar, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

- i) Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar data të ndryshme për pagesën e çmimit të blerjes së pasurisë, duke krijuar konfuzion në përcaktimin e saktë të situatës reale që ka ndodhur mes tij, shitësit, huadhënësit dhe drejtueses rajonale të bankës, e cila shfaqet në cilësinë e një “ndërmjetëseje” dhe deri diku huadhënëse në cilësinë e saj personale, në veprimet e kryera për marrjen e një huaje dhe dhënien e një kredie. Deklarimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit të pasurisë nuk përputhen me provat, e konkretisht me deklaratën e z. B. më datë 08.06.2007, kontratën e shitjes të datës 20.06.2007, deklaratën e z. Dh. të datës 22.06.2007, si dhe me deklarimet në deklaratën e interesave privatë për vitin 2007 dhe në deklaratën *vetting*. Sipas subjektit, pavarësisht se shitësi ka qenë në dijeni të rrethanave dhe më datë 08.06.2007 ka pranuar nëpërmjet deklaratës noteriale që do të priste lëvrimin e kredisë për shlyerjen e pagesës, duke përcaktuar edhe një *afat* prej 15 ditësh, në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes, në kundërshtim me sa kishte rënë dakord, kërkonte paratë në dorë.
- ii) Përpos këtij qëndrimi të ndryshuar papritmas nga shitësi, shpjegimet e subjektit, edhe më tej, bazohen kryesisht në veprime kontradiktore që bien ndesh edhe me dokumentacionin në fashikull. Nëse pranohet versioni i ngjarjeve sipas pretendimit të subjektit, zbatuar në rrethanat e dokumentuara nga aktet, do të thotë që pavarësisht nga sa ishte rënë dakord më herët mes palëve, duke filluar nga qershori 2007, dhe ndryshimit të papritur të kërkesave nga shitësi, gjithsesi ditën kur ky i fundit nënshkroi kontratën [20.07.2007] dhe pasuria u regjistrua në emër të blerësit/subjektit, pagesa ishte shlyer realisht, ndonëse në kontratë blerësi përsëri u angazhua të paguhej më vonë – pas lëvrimin të kredisë.
- iii) Së fundmi, rrjedha e fakteve që përpiqet të provojë subjekti, krahasuar me panoramën e ofruar nga aktet, dëshmon që ndërsa shitësi dhe blerësi kanë dokumentuar rregullisht, edhe në prani të noterës, veprime paraprake të shumëfishta, sikurse aplikimi në bankë dhe dakordësia për blerjen në të ardhmen, fazën kyçe me peshë vendimtare të procesit – shlyerjen e pagesës – palët kanë zgjedhur ta kryejnë jo vetëm jashtë zyrës noteriale, por edhe në prani të një individi, qoftë edhe në kapacitet profesional, që nuk ka tagra të një shërbimi me karakter publik – në zyrën e drejtueses rajonale të bankës pranë së cilës blerësi kishte aplikuar për kredi – dhe e cila në atë moment vepron njëkohësisht në cilësinë e saj profesionale e njëkohësisht individuale – si huadhënëse.
- iv) Në deklaratën *vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se çmimi i shitjes është likuiduar më datë 22.06.2007, “ditën kur është lëvruar kredia nga banka”. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se çmimi është likuiduar më datë 20.06.2007 – që është data e kontratës së shitjes dhe

regjistrimit të pronës, ndërkohë që nga të dhënat e llogarisë bankare konstatohet se tërheqja e kredisë ka ndodhur më datë 25.06.2007.

v) Subjekti i rivlerësimit nuk ka përbushur detyrimet ligjore sipas të cilave do të duhej të kishte deklaruar huan nga z. Dh. si burim të krijimit të pasurisë, dhe as të dhënat e huadhënësit. Këto të dhëna kanë rezultuar gjatë procesit të rivlerësimit, në saje të përgjigjes së datës 12.02.2018 nga Raiffeisen Bank për llogaritë bankare dhe kreditë e marra nga subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij. Bashkëlidhur kontratës së kredisë për blerjen e apartamentit gjendet edhe kopja e deklaratës noteriale të z. Dh. dhe subjektit të rivlerësimit, e qershorit 2007. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë për herë të parë informacion për huan e marrë dhe situatën e ndodhur vetëm pasi ka marrë një pyetje konkrete nga Komisioni, më datë 24.05.2018, për mënyrën e kryerjes së pagesës së shumës 3.000.000 lekë. Së bashku me shpjegimet për herë të parë, subjekti ka bashkëlidhur edhe dokumentacionin për rrethanat e marrjes së huas.

vi) Në asnjë prej deklaratave të interesave privatë, duke filluar nga viti 2007, dhe as në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se pagesa është likuiduar me huan e marrë nga z. Dh. e më tej që kjo hua është likuiduar me kredinë e marrë në Raiffeisen Bank. Siç është shtjelluar edhe më herët, në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm kredinë si burim për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë. Mbështetur në parashikimet kushtetuese, ligjore dhe nënligjore, sikurse përmbajtja e nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, e nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe e pikës 7 të udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të dorëzonte deklaratën *vetting* të shoqëruar me të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë – në këtë rast të apartamentit të banimit në Gjirokastër – duke deklaruar me vërtetësi burimin, në momentin e krijimit/fitimit të tij. Kjo qasje e subjektit bie ndesh ose anashkalon edhe orientimet e detajuara dhe të shumta të paraqitura në vetë formularin e deklaratës *vetting*, në të cilin në mënyrë konsistente kërkohet pasqyrimi i *burimit* të krijimit të pasurisë. Konkretisht, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, përcaktohet se objekt i deklarimit janë: [...] *Të gjitha pasuritë e akumuluarra ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 [...], burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to [...]* të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit [...]. Po në këtë formular, lidhur me shpjegimin dhe nivelin e detajimit, përfshirë edhe burimin, kërkohet përshkrim i hollësishëm për: [...] *llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloji pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë [...]*. Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, kërkohen të dhëna lidhur me: [...] *burimet e origjinës së pasurive, identitetin e personit juridik ose fizik huadhënës ose huamarrës, [...]*, ndërsa në rubrikën vijuese kërkohen të dhëna për personat që rezultojnë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që mbart detyrimin për deklarim.

vii) Argumentimi i subjektit të rivlerësimit për mosdeklarimin me saktësi dhe me vërtetësi të deklaratës *vetting*, për shkak të *harresës nga koha e gjatë e kaluar prej 12 vitesh*, nuk është bindës. Së pari, vlera e huas ka përbërë burimin bazë dhe të vetëm të gjithë vlerës së blerjes së apartamentit. Së dyti, rrethanat e përshkruara nga vetë subjekti, sipas të cilit, pasi palët kishin rënë dakord, shitësi ndërroi kushtet për të lidhur kontratën papritmas dhe në kundërshtim të plotë me sa ishte vepruar deri në atë çast, duken rrethana serioze pengesash të cilat duhet të jenë më së pakti mbresëlënëse në kushtet kur subjektit i është dashur të mbështetet te “ndihma humane” e qytetarëve të tjerë “pa interes” dhe në kushtet e “nevojës së ngutshme”. Së fundmi, nuk është bindës edhe argumenti i subjektit të rivlerësimit se nuk e ka deklaruar huan, duke qenë se ajo u shlye në krye të 4-5 ditëve.



Ligji nuk rezulton të ketë bërë diferencim mes llojit të huave, afatgjata apo afatshkurtra, si burim krijimi pasurish. Subjekti i rivlerësimit në asnjë moment nuk ka deklaruar lidhjen e tij të interesit me z. Dh., duke u gjendur kështu në situatën e një deklarimi të pasaktë dhe të paplotë.

viii) Për sa më sipër, trupi gjykues konstatoi mospërputhje mes deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, deklarimeve gjatë procesit të rivlerësimit dhe përmbajtjes së dokumenteve të kohës, e konkretisht deklaratës së z. B. të datës 08.06.2007, kontratës së shitjes së datës 20.06.2007 dhe deklaratës së z. Dh. të datës 21.06.2007. Konkretisht, ndërsa në kontratën e shitjes së pasurisë të datës 20.06.2007, mes z. B. dhe subjektit, palët bien dakord që shlyerja e pagesës së apartamentit do të lidhej me lëvrimin e kredisë, të nesërmen, në deklaratën noteriale të datës 21.06.2007, lëvrimi i kredisë lidhet nga palët – tanimë subjekti dhe z. Dh. – edhe me shlyerjen e huas. Sipas së njëjtës deklarate noteriale [të huas], parashikohej se detyrimi i huas do të derdhej në llogarinë bankare të z. Dh., parashikim i konfirmuar nga subjekti edhe në përgjigjet e datës 31.05.2018<sup>29</sup>. Nga aktet nuk rezulton i kryer një veprim i tillë. Përkundrazi, z. Dh., në deklaratën e datës 27.06.2019, shprehet se shuma 3.000.000 lekë është marrë *cash, në dorë*. Këto të dhëna krijojnë mospërputhje dhe paqartësi për sa i përket burimit real të krijimit të pasurisë. Kjo mënyrë deklarimi ndikon edhe në kontrollin e plotë dhe të saktë të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

ix) Rrethanat në të cilat, sipas deklarimit të subjektit, u lëvrua huaja, dëshmojnë për një sjellje të drejtueses së bankës, në favor të subjektit magjistrat dhe drejtues, që nuk mund të mos krijojnë perceptimin e përfitimit të një favorit në mënyrë të parregullt dhe në dukje të një situatë të konfliktit të interesit. Sipas subjektit të rivlerësimit, huaja në shumën prej 3.000.000 lekësh “do të tërhiqej nga llogaria e z. N. Dh., ndërsa shuma e kredisë do të kalonte direkt në llogarinë e znj. R. Dh.” ose sikurse është pretenduar në mënyrë të pavërtetë, *kaloi direkt në llogarinë z. N. Dh.* Në përmbledhje, drejtuesja e bankës nga e cila subjekti priste të përfitonte kredi, “konkurronte” me bankën në cilësinë e huadhënëses, duke i ofruar një klienti të bankës – një funksionari të lartë të drejtësisë – fonde personale/familjare si hua, për të anashkaluar kushtet e vendosura nga banka. Ky transaksion ndodh në një qytet ku roli zyrtar dhe individ i ndërthuren logjikshëm e në mënyrë të qëndrueshme për një vëzhgues të pavarur. Subjekti, një magjistrat dhe drejtues prokurorie, minimalisht ishte dëshmitar i një mënyre veprimi nga një funksionare e bankës që, duke e favorizuar atë [subjektin], haptazi konkurren me parimet ekonomike që lejojnë ekzistencën e një institucioni financiar, në ambientet e vetë institucionit dhe nëpërmjet llogarisë bankare personale të drejtueses së institucionit, apo të familjarit të saj të afërt.

**24.7.** Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka administruar mjaftueshëm të dhëna që adresojnë nevojën për të kuptuar marrëdhënien e subjektit me z. B. për blerjen e apartamentit, nga njëra anë, dhe me z. Dh. për marrjen dhe likuidimin e huas, nga ana tjetër. Të tilla janë dëshmia e znj. R. Dh., marrë më datë 07.02.2019, dhe aktet e kohës që dokumentojnë mënyrën si palët kanë deklaruar se do të kryenin likuidimin e çmimit të apartamentit, sikurse kontrata e shitblerjes e datës 20.06.2007, mbi bazën e së cilës banka miratoi kredinë në datën 22.06.2007. Ndërsa subjekti kërkoi t’i provojë këto veprime në ankim me thirrjen e tre dëshmitarëve, sikurse znj. Dh., z. B. dhe znj. Sh., për trupin gjykues të Kolegjit, mbetet fakt i pakontestueshëm se subjekti i rivlerësimit dhe shitësi kanë nënshkruar një kontratë shitblerjeje në të cilën të dy palët kanë rënë dakord që çmimi do të likuidohej *pas lëvrimit* të kredisë. Në kushtet

---

<sup>29</sup> Subjekti ka pretenduar në përgjigjet e pyetësorit se vlera e kredisë prej 2.850.000 lekësh kaloi direkt në llogarinë bankare z. Dh., ndërsa pjesa e mbetur prej 150.000 lekësh i është dhënë në dorë nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes. Faqe 1 dhe 2, pyetja e parë.

kur deklarimet e shitësit dhe të blerësit kontestojnë çfarë ata vetë kanë dakordësuar në kontratë, kjo situatë më së paku krijon perceptimin që kontrata e shitblerjes përmban elemente pavërtetësie dhe keqbesimi në raport me bankën, e cila ka lëvruar kredinë bazuar në këtë akt.

25. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka arritur të provojë plotësisht ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të z. N. Dh. për dhënien e huas në vlerën 3.000.000 lekë. Ai parashtroi se në vitin 2007 e ka konsideruar si të pavend, joetike, jonjerëzore që pikërisht në atë moment t'i kërkonte burimin e ligjshëm të të ardhurave, ndërkohë që z. Dh. dhe bashkëshortja e tij njiheshin si një familje e nderuar, pa asnjë konflikt me ligjin. Huadhënësi kishte një aktivitet tregtar prej vitesh, i regjistruar me vendim gjykatë, në vitin 1992, ndërsa bashkëshortja e tij ishte drejtoreshë rajonale në Raiffeisen Bank.

25.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, të dhënat nga Drejtoria e Tatimeve Gjirokastrë, si dhe ato të hetimit administrativ provojnë se z. Dh. ka të ardhura të mjaftueshme kundrejt vlerës së huas prej 3.000.000 lekësh. Për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të dy bashkëshortëve Dh., së bashku apo veç e veç, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një akt ekspertimi. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit se burimi i ligjshëm i të ardhurave të z. Dh. nuk është provuar me dokumentacion ligjor, është i gabuar. Nga ekstraktet e llogarive bankare të z. Dh. dhe znj. Dh. pasqyruar në aktin e ekspertimit, rezultojnë tërheqje shumë në vlera të konsiderueshme në vitet 2005-2006, fakte që provojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre familjare. Së fundmi, në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar pjesë nga arsyetimi i vendimeve të Komisionit që u përkasin subjekteve të rivlerësimit K. B. dhe E. N. dhe si argument shtesë për shkeljen e parimit të barazisë dhe “përdhosjes së standardeve”, ka referuar pjesë të vendimit të Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit A. D..

25.2. Nga shqyrtimi i rezultateve të hetimit administrativ, konstatohet se Komisioni e ka konsideruar z. Dh. *person tjetër të lidhur*, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, duke i kërkuar të provojë me dokumentacion burimin e ligjshëm të të ardhurave për dhënien e shumës 3.000.000 lekë – gjatë marrjes së dëshmisë së saj. Më tej, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me mosprovimin me dokumentacion të burimit të ligjshëm të të ardhurave të z. Dh., për dhënien e huas në shumën 3.000.000 lekë. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur [z. Dh.], për dhënien e huas objekt hetimi. Sipas Komisionit, dokumentacioni i dorëzuar nuk pasqyron fitimin e realizuar, në mënyrë që të përlllogaritet aftësia paguese e z. Dh..

25.3. Nga aktet rezulton që Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë (DRT Gjirokastrë), më datë 14.11.2018, ka përcjellë edhe vetëdeklarimet e subjektit tregtar N. Dh., për periudhën 2004 – 2007, si dhe pagesat e kryera mbi kontributet. Më datë 28.06.2019, DRT Gjirokastrë ka informuar subjektin e rivlerësimit për qarkullimin e deklaruar të subjektit tregtar në emër të personit tjetër të lidhur për periudhën 2003–2007 dhe tatimin e paguar<sup>30</sup>. Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, lidhur me ligjshmërinë e burimeve financiare të z. Dh. për dhënien e huas, subjekti

---

<sup>30</sup> Sipas shkresës së DRT Gjirokastrë, qarkullimi ka qenë gjithsej 11.757.000 lekë, ndërsa tatimi i paguar 255.000 lekë. QKB-ja po ashtu ka informuar Komisionin se z. Dh. është regjistruar si person fizik me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë të janarit 1992. Në fashikull ndodhet edhe ekstrakti i personit fizik, mbajtur nga QKB-ja.

i rivlerësimit ka shpjeguar, ndër të tjera, se z. N. Dh. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e huas në vlerën 3.000.000 lekë.

**25.4.** Në dosje nuk rezulton të jenë administruar të dhëna bankare apo dokumentacion i kohës që të mund të vërtetohet se vlera 3.000.000 lekë buron nga të ardhura të ligjshme. Konstatohet se Komisioni nuk ka kryer analizë financiare të plotë për të verifikuar aftësinë paguese të z. Dh., në cilësinë e personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Bazuar në dokumentacionin bankar të bashkëshortëve Dh., nuk rezulton që z. N. Dh. apo bashkëshortja e tij të kenë pasur gjendje 3.000.000 lekë në bankë në datën 20.06.2007, si edhe nga dokumentacioni i dorëzuar prej subjektit në lidhje me të ardhurat e z. N. Dh., nuk evidentohet fitimi i realizuar<sup>31</sup>. Gjithashtu, nga lëvizjet e llogarive bankare në emër të N. e R. Dh., vërehet re se gjatë periudhës 2005-2007 ka depozitime e tërheqje *cash* në vlera të konsiderueshme, të cilat nuk provojnë ligjshmërinë e burimeve të të ardhurave të familjes Dh..

**25.5.** Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që në përlllogaritjen e burimeve të ligjshme të personit të lidhur të përfshihen edhe të ardhurat nga paga të bashkëshortes. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të theksojë *së pari* se mbetet fakt i pakontestueshëm se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë burim për krijimin e pasurisë në deklaratën *vetting*, çka e vendos atë në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm. Ky pretendim duket se ngrihet nën dritën e konkluzionit të arritur nga Komisioni për mungesë burimesh të ligjshme nga biznesi i z. Dh.. Po kështu, mbetet fakt i pakontestueshëm që kjo analizë dhe pretendimet e reja, ku pasqyrohen kryesisht tërheqjet nga llogaritë bankare dhe të ardhurat e znj. Dh., bien ndesh me sa është deklaruar nga vetë znj. Dh. dhe subjekti i rivlerësimit në hetim, dhe duket se përbëjnë një përpjekje për të provuar një variant alternativ. Së dyti, trupi gjykues i Kolegjit, në përgjigje të ankimit të subjektit të rivlerësimit, konstaton se i vetmi burim i ligjshëm i provuar i të ardhurave të familjes Dh., janë të ardhurat e znj. R. Dh. nga punësimi pranë Bankës Raiffeisen. Në gjendjen që janë aktet, nga dokumentacioni i administruar në dosje, mungon informacion që do të lejonte kryerjen e një analize të plotë financiare mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave të familjes Dh.. Duke i analizuar të ardhurat e dokumentuara, në kushtet kur informacioni është i kufizuar, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se familja Dh. mund të mbulojë shpenzimet e jetesës sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT për një familje me 4 persona nëse merren në konsideratë të ardhurat e znj. Dh. nga punësimi pranë Bankës Raiffeisen për periudhën tetor 2004 – 20 qershor 2007. Në këtë analizë u morën në konsideratë edhe të ardhurat nga paga e z. Dh. deri në nivelin e pagës minimale të sigurueshme, për efekt të përlllogaritjes së sigurimeve shoqërore, meqenëse nga aktet rezulton që

---

<sup>31</sup> Sipas dokumentacionit bankar të znj. R. e z. N. Dh., administruar nga Komisioni, rezulton se z. N. Dh. ka pasur një depozitë me afat në bankën NBG (sot ABI Bank), çelur para vitit 1998, mbyllur/transferuar në datën 05.04.2006, me balancë maturimi 2.099.917 lekë. Dokumentacioni nuk specifikon nëse këto fonde janë tërhequr *cash* apo janë transferuar në ndonjë llogari tjetër. Ndërsa, znj. R. Dh. ka pasur investime në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë për periudhën 2001-2012. Investimi fillestar në vitin 2001 është bërë për një bono me vlerë maturimi 2.000.000 lekë. Në vitin 2006, rezulton se znj. Dh. ka pasur në pronësi 3 letra me vlerë, me maturim përkatësisht tremujor dhe njëvjeçar, me vlera nominale 3.000.000 lekë, 5.000.000 lekë dhe 2.700.000 lekë. Bonot me maturim tremujor nuk janë riinvestuar. Bonoja me maturim njëvjeçar, me vlerë maturimi 5.000.000 lekë, pas maturimit në datën 27.03.2007, është riinvestuar në një letër me vlerë nominale 2.000.000 lekë. Po kështu, z. N. Dh. ka pasur investime në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë për periudhën 2003-2006. Investimi fillestar është bërë më datë 09.01.2003 për një bono me vlerë maturimi 900.000 lekë. Vlera e investimit në bono thesari në datën e maturimit, 06.07.2006, ka qenë 1.200.000 lekë.

për këtë periudhë z. Dh. ka paguar rregullisht detyrimet për sigurime shoqërore e shëndetësore. Vlera që mbetet pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës, është 3.113.681 lekë. Kjo vlerë, edhe në versionin më minimalist të shpenzimeve – duke prezumuar që familja Dh. nuk ka kryer investime, kursime apo shpenzime të tjera që përgjithësisht shoqërojnë standardin e zakonshëm të jetesës – mbetet teorike dhe me vlerë të kufizuar provuese në mungesë hetimi e dokumentacioni, përkundër aftësisë për të dhënë hua në një vlerë thuajse të barabartë subjektit të rivlerësimit.

**25.6.** Në përmbledhje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar huan si burim për krijimin e pasurisë. Aktet e administruara gjatë hetimit dhe shpjegimet e deklarimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit, për marrjen dhe likuidimin e saj me kredinë e destinuar për blerjen e pasurisë, krijuan paqartësi dhe konfuzion, duke bërë që sjellja e tij në raport me qëllimin e procesit për kriterin e pasurisë të mos arrijë nivelin e besueshëm sikurse parashikon neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

- 26.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka zbatuar gabim nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 duke cenuar qëllimin e ligjvënësit, të ligjit në tërësi dhe të vetë Kushtetutës, të cilët synojnë të largojnë nga sistemi i drejtësisë personat që janë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme dhe si pasojë e tyre kanë krijuar pasuri, dhe jo personat që mund të kenë pasaktësi në deklarimet e tyre, që nuk kanë asnjë indicie minimale për përfshirjen në veprimtari të paligjshme apo të papajtueshme me detyrën e tyre. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, nuk ka pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, ndaj edhe shkaqet kushtetuese që sjellin automatikisht prezumimin në favor të masës disiplinore të shkarkimit nuk vërtetohen. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, pasi nuk ka asnjë provë që “pasaktësitë” e pretenduara nga Komisioni të jenë bërë me qëllim fshehjen e burimit të të ardhurave apo pasurisë dhe, në zbatim të parimit të proporcionalitetit, këto “pasaktësi” nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit dhe nuk cenojnë figurën e gjyqtarit/prokurorit dhe as besimin e publikut te drejtësia.

**26.1.** Nga faktet dhe analiza e trajtuar në paragrafët e mësipërm, rezulton se ndonëse subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e pasjes së një pasurie më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme dhe ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë, ai ka paraqitur në mënyrë të pasaktë burimin e krijimit të pasurisë në pronësi në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore. Vetëm si pasojë e hetimit të kryer nga Komisioni, subjekti është detyruar të japë shpjegime për huan që ka përbërë burimin kryesor të krijimit të pasurisë në momentin e krijimit të saj. Kjo situatë faktike e vendos atë haptazi në situatën e deklarimit të paplotë dhe të pasaktë. Nga ana tjetër, pasaktësitë në deklarime nuk duket të kenë qenë baza mbi të cilën është konkluduar aplikimi i masës disiplinore të shkarkimit nga Komisioni.

Po ashtu, argumentet mbështetëse të subjektit të rivlerësimit se qëllimi i procesit të rivlerësimit është largimi i personave që kanë kryer veprime të kundërligjshme, nuk janë të bazuara në gjuhën apo frymën e ligjit. Dyshimet apo konstatimet për veprimet e kundërligjshme, për nga natyra, përbëjnë objektin e një procedimi penal ndaj këtyre personave. Qëllimi i procesit të rivlerësimit është shprehur qartë në Kushtetutë dhe në ligj, përfshirë nenin 61 të ligjit nr. 84/2016. Dhënia e masës disiplinore mbështetet në konstatimin e gjetjes së një prej pesë rrethanave, ndër të cilat është edhe deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë – mbi bazën e të cilit Komisioni ka dhënë masën

disiplinore. Për të vërtetuar që nuk gjenden në asnjë prej këtyre rasteve, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin e barrës së provës. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit kishte barrën e provës për të shpjeguar bindshëm deklaratimet dhe të ardhurat dhe për të rrëzuar çdo gjetje, e cila e vendoste atë në kushtet e deklaratimit të pamjaftueshëm të pasurisë apo që në vlerësimin tërësor nuk kishte cenuar besimin e publikut<sup>32</sup>. Kuptimi dhe zbatimi i nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe i dispozitave të ligjit nr. 84/2016, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, kërkojnë që deklarimi i subjektit të rivlerësimit të jetë i besueshëm, i pacenueshëm në vërtetësi dhe në plotësi. Në këtë kontekst, deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pasaktë, i pavërtetë dhe i paplotë pasi nuk ka deklaruar një burim të krijimit të pasurisë, i cili në momentin e krijimit të pasurisë ka përbërë burimin bazë dhe të vetëm të saj, në kushtet kur huaja në vlerën 3.000.000 lekë ka mbuluar të gjithë vlerën e blerjes së apartamentit me çmimin 3.000.000 lekë.

**26.2.** Në përfundim, duke analizuar sa më sipër veprimet e subjektit të rivlerësimit dhe rrethanat në të cilat është krijuar pasuria, si dhe qasjen e tij kontradiktore dhe evazive ndër vite dhe sidomos në deklaratimin për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut të drejtësia. Me fjalë të tjera, subjekti në mënyrë konsistente ka qenë kontradiktor dhe ka zgjedhur mungesë vërtetësie në deklaratimet e tij në deklaratën e pasurisë dhe në procesin e rivlerësimit, përfshirë edhe në deklaratën *vetting*, sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie, ka qenë kontradiktor në shpjegimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit në raport me të dhënat e dokumentacionit të administruar, si dhe në analizën tërësore të rrethanave, në të cilat pretendohet të jetë marrë huaja – nga fondet familjare të një funksionareje drejtuese të bankës për të anashkaluar politikat e bankës për kreditë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson ta trajtojë këtë konkluzion së bashku me gjetjet në vijim, në analizë të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, në drejtim të cenimit të besimit të publikut.

#### *D. Shkaqet në ankim që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale*

- 27.** Subjekti pretendon se Komisioni ka kryer interpretim të zgjeruar të parashikimeve të pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Cenimi i besimit të publikut të drejtësia aplikohet nëse subjekti ka cenuar të tria kriteret dhe, për rrjedhojë, qëndrimi i mëtejshëm në punë i tij vlerësohet i pamundur për shkak se është cenuar besimi publikut të drejtësia. Subjekti argumenton se Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë raportin e Prokurorisë së Përgjithshme, në rolin e organit ndihmës, në vlerësimin e kriterit të vlerësimit profesional, si dhe qëndrimin korrekt dhe bashkëpunues të tij përgjatë procesit. Këto të fundit janë përmendur, por nuk janë pjesë e vlerësimit tërësor të çështjes, gjë që cenon parimin e objektivitetit. Në vlerësimin e këtij kriteri, Komisioni paraqet argumentet në mënyrë konfuze dhe të përsëritur, duke krijuar perceptimin e një numri të lartë konstatimesh. Vlerësimi i Komisionit është i pambështetur në prova dhe i pavërtetë, dhe ka shkelur parimin themelor të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, të sanksionuar në nenet 7 dhe 145, pikat 1 dhe 3 të Kushtetutës.

**27.1.** Nga aktet, rezulton që raporti i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit i është përcjellë Komisionit nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme më datë 17.04.2018. Raporti bazohet në analizën e 3 (tri) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i

---

<sup>32</sup> Përcaktuar nga neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe zbatimin e parimeve të tij ndër të tjera në nenet 52, pika 2 dhe 32 të ligjit nr. 84/2016.

rivlerësimit, 5 (pesë) dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor, si dhe në të dhënat nga burimet arkivore të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

**27.2.** Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk justifikonin moskryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme të konstatuara në rastet e shqyrtuara, mosnjohimin e vendimeve palëve të interesuara, mosargumentimin e vendimeve të pushimit apo mosfillimit. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional, Komisioni çmoi se të metat e konstatuara në shqyrtimin e dosjeve gjyqësore, reflektojnë mangësi profesionale të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Të tilla mangësi u konsideruan: (i) moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme; (ii) mënyra jokorrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave; (iii) argumentimi i paplotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat në tërësi bien ndesh me kriteret e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 73 dhe në pikën 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016. Për pasojë, Komisioni i ka vlerësuar këto mangësi si cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij. Në përfundim, në vlerësimin veç e veç, si dhe në tërësi të kriterit profesional, Komisioni konsideroi se subjekti nuk arrin një nivel të besueshëm në sistemin e drejtësisë, pasi është cenuar besimi i publikut te sistemi i drejtësisë.

**27.3.** Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se vlerësimi i kriterit profesional ishte kryer nga organi ndihmës dhe duhej të përbënte bazën e vlerësimit për të, janë të pambështetura në ligj. Siç është shtjelluar gjerësisht edhe më herët në jurisprudencën e Kolegjit<sup>33</sup>, dispozitat e ligjit nr. 84/2016, konfirmuar edhe nga qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, parashikojnë që institucionet e rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin, gëzojnë tagrin që të kryejnë hetimet e tyre, përpos hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, si dhe të kryejnë verifikime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit. Nga ana tjetër, qëndrimet e subjektit të rivlerësimit përgjatë procedurës së rivlerësimit dhe shkëmbimet që ka kryer ai me Komisionin, kanë gjetur pasqyrim në rubrikën III të vendimit “Qëndrimi dhe mendimi i subjektit të rivlerësimit” (faqe 4). Sjellja dhe qasja e tij korrekte përbëjnë vlerë pozitive minimale që pritet nga një magjistrat, por nuk mund të argumentohen se janë mjaftueshmërisht determinuese në vlerësimin përfundimtar të procesit.

**27.4.** Nga shqyrtimi i vendimit, rezulton se pavarësisht se Komisioni ka konstatuar mangësi profesionale të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit, duke cituar edhe mangësitë konkrete në raport me dispozitat ligjore, sikurse ato të ligjit nr. 96/2016 [nenet 73, pika 3 dhe 74, pika 4], në konkluzionin përfundimtar ato janë lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, duke aplikuar pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Me fjalë të tjera, si rezultat i hetimit të kryer, masa disiplinore nuk është aplikuar sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016: [...] 4. Kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale [...].

**27.5.** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vlerësimi i Komisionit është i pambështetur në prova dhe i pavërtetë, dhe ka shkelur parimin themelor të Kushtetutës, të pavarësisë së pushtetit gjyqësor të sanksionuar në nenet 7 dhe 145, pikat 1 dhe 3 të Kushtetutës, analizohet në referim të

---

<sup>33</sup> Shih paragrafin 18 dhe nënparagrafët e tij në vendimin nr. 16/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit H. D.; paragrafët 45 dhe 46.3 të vendimit nr. 6/2020 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit A. Ç.; paragrafin 100 të vendimit nr. 26/2019 (JR) që i përket subjektit të rivlerësimit R. T..

parashikimeve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 që trajton aftësitë profesionale të prokurorit, ku në çdo rast, vlerësuesit – në këtë rast, institucionet e rivlerësimit – Komisioni dhe Kolegji – i çmojnë aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet. Ky pretendim është trajtuar gjerësisht në vijim, gjatë analizës së pretendimeve mbi rastet konkrete.

**27.6.** Lidhur me pretendimin se neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, aplikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka ceduar në të tria kriteret e, për rrjedhojë, qëndrimi në detyrë i tij do të cenonte besimin e publikut, është i pabazuar. Gjuha e ligjit nuk e lidh aplikimin e këtij konkluzioni në formë kumulative me secilin prej kriterëve. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, cenimi i besimit të publikut lidhet me vlerësimin tërësor sipas kuptimit të nenit 4, pika 2 e ligjit, që përcakton vendimmarrjen në një ose disa kriterë apo vlerësimin tërësor të procedurave. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj.

- 28.** Subjekti pretendon se duke konkluduar se vendimi i tij për mosfillimin e procedimit penal të vitit 2013, është i padrejtë, Komisioni ka marrë përsipër rolin e gjykatës. Është në diskrecionin e çdo prokurori që, referuar neneve 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, të vlerësojë nëse duhet ta fillojë apo jo çështjen penale. Sipas subjektit të rivlerësimit, faktet objekt kallëzimi ishin të njëjta me ato që ishin hetuar edhe më parë. Për procedimin në fjalë kishte një vendim pushimi në vitin 2011, dhe subjekti ka konkluduar se nuk duhet të niste procedim penal. Subjekti thekson se Komisioni ka tejkalluar tagrat duke vlerësuar vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në themelin e saj. Ky është atribut vetëm i gjykatës. Sipas subjektit, qëndrimi i tij ishte i drejtë, përputhet me qëndrimin e organit epror të asaj kohe, ka qenë i bindur dhe e ka argumentuar në arsyetimin e vendimit dhe gjatë procedimit administrativ, duke parashtruar edhe argumentet përkatëse.

**28.1.** Argumentet e subjektit të rivlerësimit kryesisht fokusohen në faktin që kallëzimi në fjalë [ndaj gjyqtarit P. A.] është paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme më datë 14.01.2013 dhe është dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë më datë 26.03.2013 (pas 2 muajsh e 10 ditësh), pasi është analizuar se për pjesën shtesë të kallëzimit nuk ka elemente të veprës penale. Në rast të kundërt, parashtron subjekti, kallëzimi do t'i kishte kaluar Njësisë së Përbashkët Hetimore në Gjirokastrë, e cila mbulonte edhe Sarandën. Sipas subjektit të rivlerësimit, i vetmi cedim është fakti që kallëzuesit duhet t'i ishte njoftuar vendimi i mosfillimit, në përmbushje të detyrimit ligjor. Ky mosveprim nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi prokurorin. Duhet të verifikohet edhe përgjegjësia e administratës së prokurorisë. Në raportin e hartuar nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme në lidhje me inspektimin e Ministrisë së Drejtësisë, nuk është konstatuar vendimmarrje e kundërligjshme dhe nuk është shfuqizuar ky vendim. Konkluzioni i Komisionit është i gabuar dhe bie ndesh me legjislacionin procedural penal pasi vendimi i mosfillimit duhet të merret pa u kryer asnjë veprim hetimor. Këto të fundit kryhen pasi regjistrohet procedimi. Me fjalë të tjera, vendimi i mosfillimit i marrë pas kryerjes së veprimet hetimore, do të ishte në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Sipas subjektit, vendimi që ai ka marrë, është i arsyetuar dhe në respektim të dispozitave procedurale. Në vendim arsyetohet se kallëzimi ishte dërguar në tejkallim të afateve kohore, kamerat nuk ruanin filmime për kohë të gjata, dhe subjekti fitues i procesit gjyqësor kishte fituar proceset gjyqësore civile edhe në Gjykatën e Apelit apo Gjykatën e Lartë. Për sa kohë vendimi për pushimin e një kallëzimi të paraqitur në vitin 2011, që ishte identik me kallëzimin e paraqitur në vitin 2013, nuk ishte shfuqizuar nga prokurori më i lartë apo nga gjykata, subjekti i rivlerësimit nuk mund të fillonte/regjistronte një procedim

penal. Çdo prokuror do të merrte vendim mosfillimi. Ndjekja penale nuk duhet të diktohet nga interesat e palëve kallëzuese.

**28.2.** Subjekti argumenton më tej se arsyetimi i Komisionit bazohet mbi një interpretim të gabuar dhe nuk lidhet me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 40, 41, 42, 43 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016. Po kështu, edhe nëse rezulton i vërtetë, mosnjoftimi i kallëzuesit nuk cenon asnjë të drejtë pasi në çdo kohë kallëzuesit i lind e drejta e ankimit në gjykatë.

**28.3.** Nga aktet në dosjet e Komisionit, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë, më datë 26.03.2013, ka regjistruar çështjen penale me materialin kallëzues të z. N. P.. Sipas kallëzuesit, gjyqtari P. A., në mënyrë të drejtpërdrejtë, i ka kërkuar marrje mite, në shumën 5.000 euro, në këmbim të një vendimi në favor të tij. Kallëzuesi ka pretenduar që gjyqtari P. A. është takuar me djalin e palës paditëse [z. A. T.], në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, më datë 07.01.2013. Gjatë takimit, pala paditëse i ka dhënë gjyqtarit vendimin e përfunduar të shpallur në datën 08.01.2013. Kallëzuesi pretendon se takimi në fjalë është regjistruar nga kamerat e sigurisë së gjykatës. Këto pamje, sipas tij, përbëjnë edhe provën themelore të njëanshmërisë së gjyqtarit. Një ditë më pas, në datën 08.01.2013, gjyqtari ka shpallur vendimin përfundimtar, në mungesë të denoncuesit që ishte palë e paditur – ndërkohë, vendimi pasqyron se denoncuesi ishte i pranishëm.

**28.4.** Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë<sup>34</sup>, më datë 03.05.2013, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}, që i përket kallëzimit penal të dërguar pranë kësaj prokurorie nga Prokuroria e Përgjithshme më datë 25.03.2013<sup>35</sup> dhe që lidhet me kallëzimin e mësipërm. Në vendimin e mosfillimit, subjekti i rivlerësimit arsyeton se duke qenë se ngjarja e pretenduar ka ndodhur në muajin janar 2013, marrja e pamjeve filmike ka qenë e pamundur, pasi ato ruheshin deri në 20 ditë. Më datë 30.04.2013, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka informuar se çështja penale e regjistruar më datë 02.05.2011, me të njëjtin objekt, bazuar në një kallëzim të ushtruar nga z. N. P., është pushuar më datë 09.08.2011.

**28.5.** Në raportin e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me rezultatet e inspektimit të ushtruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë në qershor 2016, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorëve në procedimet penale të mosfilluara dhe atyre me hetime paraprake të përfunduara me vendim pushimi për periudhën 01.01.2013 – 31.05.2014, janë pasqyruar rezultatet e verifikimit të dosjes që i përket kallëzimit penal nr. {\*\*\*} për veprën penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, ndër të tjera, dhe shpërdorim detyre, të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 248 të Kodit Penal, nga subjekti i rivlerësimit. Nga analiza e akteve të këtij rasti, rezulton se prokurori *nuk e ka ushtruar* funksionin e tij për ndjekjen penale dhe kryerjen e hetimeve. Sipas raportit, nuk janë kryer as minimumi i veprimeve të sugjeruara nga kallëzuesi. Prokurori [subjekti i rivlerësimit] është mjaftuar vetëm me faktin se Prokuroria e Gjirokastrës ka vendosur dy vite më herët [më datë 09.08.2011] pushimin e çështjes, pavarësisht se episodi që pretendohet i përket një periudhe të mëvonshme. Po ashtu, raporti konstaton se materiali duhet t'i ishte përcjellë për ndjekje

---

<sup>34</sup> *Dosja penale është përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë në Prokurorinë e Përgjithshme më datë 31.10.2018.*

<sup>35</sup> *Në shkresë, Prokuroria e Përgjithshme, përveç dërgimit për kompetencë e zgjidhje ligjore materialin, shprehej edhe për njoftimin e letërshkruesit mbi vendimarrjen për ankesën.*



Prokurorisë së Gjirokastrës, në zbatim të nenit 78 të K.Pr.Penale, dhe jo prokurorisë pranë gjykatës ku ushtronte detyrën gjyqtari i kallëzuar. Po ashtu, nga analiza, rezulton se nuk janë respektuar parimet e drejtësisë, barazisë dhe ligshmërisë së veprimtarisë së prokurorit në marrëdhëniet me subjektet e tjera të procedimit penal, pasi nuk rezulton të jetë bërë njoftimi i vendimit të mosfillimit të atyre që kanë bërë kallëzimin, në kundërshtim me parashikimet e nenit 291/2 të K.Pr.Penale, duke cenuar të drejtën e palëve për ushtruar të drejtën për t'u ankuar në gjykatë. Së fundmi, referimi në nenin 290/1, germa “dh” është i gabuar, pasi i referohet mosfillimit për shkak të amnistisë, ndërkohë që nuk rezulton të jetë ky shkak ligjor i mosfillimit.

**28.6.** Në ndryshim nga raporti i Ministrisë së Drejtësisë, relacioni i Prokurorisë së Përgjithshme [Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore] rezulton të ketë konstatuar që kallëzuesi ka paraqitur të njëjtat fakte në të dy kallëzimet, në dy vite të ndara me hark kohor dy-vjeçar [2011 dhe 2013]. Sipas këtij raporti, vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë për mosfillimin e procedimit penal *ka qenë i drejtë*. Relacioni konstaton faktin që kallëzimi i vitit 2013 i është përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë nga Prokuroria e Përgjithshme, meqenëse kallëzimi i vitit 2011 ishte pushuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe bëhej fjalë për të njëjtin kallëzim. Së fundmi, relacioni i Prokurorisë së Përgjithshme sugjeron që kallëzimi i është përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë me qëllim që të vendosej mosfillimi i procedimit për këtë shkak, ndërsa referenca e gabuar dhe dështimi në njoftimin e vendimit kallëzuesit, sipas nenit 291/2 të K.Pr.Penale, qëndrojnë.

**28.7.** Nga sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për veprime të kundërligjshme nga një gjyqtar në muajin janar 2013, të regjistruar mbi një kallëzim të të njëjtit vit, duke përdorur arsyetimin se një prokuror tjetër ka vendosur pushimin e procedimit në vitin 2011 për një fakt të ndodhur më herët. Me fjalë të tjera, ndërsa kallëzuesi pretendonte ngjarje të ndodhura në janar 2013, subjekti i rivlerësimit ka bazuar vendimin e mosfillimit për një ngjarje të vitit 2013 në një vendim të mëhershëm të prokurorisë për hetimin e një ngjarjeje të ndodhur në 2011. Nga krahasimi i dy kallëzimeve, vihet re që ndonëse kallëzues është i njëjti individ/palë ndërgjyqëse, për të njëjtin gjyqtar, për të njëjtën mosmarrëveshje civile në gjykim në një hark kohor disavjeçar, me të njëjtat palë, veprimet për të cilat kërkoheshin verifikime nga prokuroria u përkasin periudhave të ndryshme. Më konkretisht, në kallëzimin e vitit 2011 pretendohet për marrje mite nga gjyqtari në vlerën 5.000 euro [ngjarje e pretenduar që ka ndodhur në muajin dhjetor 2010] dhe për kërkesën nga gjyqtari për një apartament [ngjarje e pretenduar se ka ndodhur në muajt mars – prill 2011], ndërsa në kallëzimin e vitit 2013 pretendohet se gjyqtari është takuar me përfaqësuesin e njëres nga palët në ambientet e gjykatës dhe ka marrë prej tij tekstin e vendimit që do të shpallte, një ditë përpara shpalljes së vendimit [ngjarje e pretenduar se ka ndodhur në janar 2013].

**28.8.** Pavarësisht nga këto pretendime për ngjarje të ndryshme në kohë të ndryshme nga i njëjti gjyqtar, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë vendosur mosfillimin e procedimit me arsyetimin se çështja objekt kallëzimi ishte hetuar në vitin 2011, për veprime të kryera në dhjetor 2010 – prill 2011 dhe vendimi ishte marrë si pasojë e atij incidenti, ndonëse bëhej fjalë për një ngjarje të re, të ndodhur në muajin janar 2013. Po kështu, pavarësisht se subjekti vendos mosfillimin meqenëse *ngjarja është hetuar një herë në vitin 2011*, në kontradiktë me arsyetimin e tij në referencë të vendimit të marrë në 2011-ën, pa asnjë mbështetje në ligj dhe në fakte, subjekti vendos bazuar mbi faktin që kamerat nuk ruajnë pamje për një periudhë mbi 20 ditë, duke nënkuptuar ekzistencën e një ngjarjeje të pretenduar në janar 2013 gjithsesi.

**28.9.** Disponimi nga ana e subjektit të rivlerësimit me vendim për mosfillimin e procedimit penal, përpos problematikave të evidentuara në raportin e Ministrisë së Drejtësisë dhe në relacionin e Prokurorisë së Përgjithshme, sikurse mungesa e njoftimit të kallzuesit mbi vendimin e dhënë apo referimet e gabuara ligjore, për një vëzhgues të jashtëm krijon premisa serioze të cenimit të besimit të drejtësisë, në kontekstin e mosveprimit apo veprimeve të qëllimshme për të mos lejuar mbajtjen e përgjegjësisë penale dhe penguar ndëshkimin e korrupsionit në radhët e gjyqësorit. Ky perceptim bëhet më i rëndësishëm dhe i mprehtë për të evituar përshtypjen në publik, që vetë anëtarët e sistemit të drejtësisë përdorin sistemin për të evituar përgjegjësinë dhe disiplinimin e sistemit, duke krijuar efektin e pandëshkueshmërisë në perceptimin e publikut. Të gjitha këto veprime krijojnë perceptimin e një atmosfere në të cilën veprimet korruptive/shpërdorimit të detyrës të kryera nga funksionarë të drejtësisë, mbrohen nga vetë sistemi.

**28.10.** Në analizë të sa më sipër, trupi gjyqësor i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara në fakte. Së pari, kallzimi i vitit 2013 nuk referon të njëjtat fakte dhe kërkesa për hetim sikurse ai i vitit 2011. Faktet e rastit është e pamundur t'i atribuohen pakujdesisë apo gabimit njerëzor në mirëbesim. Ky kompleks rrethanash është veçanërisht i mprehtë kur është fjala për vepra për të cilat dyshohen funksionarë të drejtësisë. Kjo bindje krijohet edhe duke pasur parasysh që, ndërsa ngjarjet e kallëzuara dhe hetuara në vitin 2011 kishin për fokus veprimet korruptive të gjyqtarit dhe përfshirjen e një personi të tretë si ndërmjetës nëpërmjet përgjimeve ambientale, veprimet e kallëzuara në vitin 2013 pretendojnë veprime të gjyqtarit që lidhen me shpërdorimin e detyrës – sipas kallzimit pretendohet se pala ndërgjyqëse kishte hartuar dhe i dorëzoi gjyqtarit vendimin që do të shpallej nga ky i fundit, në ambientet e gjykatës, teorikisht të mbikëqyrura nga elementet e sigurisë të instaluara pikërisht për këtë qëllim. Së dyti, në kushtet kur procedimi penal është regjistruar bazuar në kallëzimin e një pale që pretendon cenim të interesave të saj nga veprime të kundërligjshme, detyra e prokurorit do të duhet të kishte konsistuar në hetime *shtruese* për të provuar apo përjashtuar vërtetësinë e fakteve të kallëzuara dhe ekzistencën ose jo të elementeve të veprës penale. Nga ana tjetër, pavarësisht se sipas nenit 291 të K.Pr.Penale kallzuesi ka të drejtë që brenda 5 ditëve nga njoftimi të kundërshtojë një vendim mosfillimi në gjykatë, mungesa e njoftimit në kohë cenon të drejtën e tij për të marrë drejtësinë e kërkuar duke sjellë në këtë mënyrë një drejtësi të mohuar dhe të munguar. Për rrjedhojë, edhe nëpërmjet mosnjoftimit, subjekti i rivlerësimit ka cenuar qëllimin e dispozitave procedurale penale (nenin 291, pika 2 e K.Pr.Penale) dhe njëkohësisht ka shkelur edhe urdhërimin e përcjellë me shkresën e datës 25.03.2013 të Kabinetit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit, nuk konstatohet që ky i fundit të ketë cenuar vendimmarrjen e prokurorit në themel nëpërmjet vlerësimit të kryer për veprimet procedurale të ndjekura prej tij. Konkluzionet e Komisionit se subjekti nuk ka respektuar detyrimin ligjor për të filluar procedimin penal, nuk ka kryer hetime paraprake, si dhe nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme hetimore për kallëzimin e vitit 2013, apo se nuk ka arsyetuar vendimin e mosfillimit, nuk përbëjnë tejkalim të tagrave të Komisionit, në dritën e përcaktimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, apo zëvendësim të interpretimit apo logjikës së prokurorit, çka do të përbënin cenim të pavarësisë së tij. Gjetjet e Komisionit janë evidentuar edhe në raportin e Ministrisë së Drejtësisë dhe rezultojnë nga shqyrtimi i të dhënave të administruara nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme në kuadër të vlerësimit profesional. Për rrjedhojë, ka qenë i drejtë dhe i bazuar në ligj edhe vlerësimi i Komisionit se *[...] shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe nga ai nuk argumentohet fakti se cila ka qenë arsyeja që hetimet nuk kanë filluar, duke marrë në konsideratë faktin se kishim të bënim me veprime të kryera në vitin*

2013. Gjithashtu, ai nuk jep asnjë sqarim në lidhje me moskryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore. Ai nuk provoi që vendimi i mosfillimit t'i jetë njoftuar kallëzuesit [...].

29. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konstatimet e Komisionit lidhur me çështjen e z. F. D. kanë anashkaluar problematikat e evidentuara nga Prokuroria e Përgjithshme që i janë atribuar një prokurori që ka pasur çështjen në hetim përpara tij. Problemet e konstatuara në të metat e hetimit të zhvilluar, sikurse ndarja e procedimit, pyetja e të pandehurit në një procedim të lidhur, administrimi i provave dhe pushimi i procedimit, i atribuohen veprimeve të kryera nga prokurorja tjetër. Në momentin që subjekti ka marrë dosjen në ngarkim të shtetasit F. D. në qershor 2008, ka konstatuar se provat ishin manipuluar dhe qëllimi ishte që ankuesi të dilte i pafajshëm, çka vërtetohet edhe nga raporti i inspektimit të Prokurorisë së Përgjithshme për këtë dosje. Si rrjedhojë, pretendon subjekti, këto problematika mund t'i atribuohen prokurores së shkarkuar, si rrethana që kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, por jo atij. Ndërsa lidhur me kualifikimin ligjor për të cilin akuzohej L. Q., subjekti i rivlerësimit thekson se vijon të ketë bindjen se ai ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, se nuk mund të ushtronte dhunë ndaj z. D. dhe se nuk ka konsumuar asnjë vepër tjetër penale.

29.1. Në raportin e Grupit të Punës të Prokurorisë së Përgjithshme, është evidentuar rasti që lidhet me ankesat/letrat e z. F. D. drejtuar Presidentit të Republikës dhe Prokurorit të Përgjithshëm, në vitet 2009 dhe 2010, kundër subjektit të rivlerësimit, lidhur me çështjet nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*} të vitit 2008. Konkretisht, ankuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit e ka marrë padrejtësisht të pandehur dhe e ka dërguar për gjykim për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/2 i K.Penal, si dhe ka pushuar padrejtësisht çështjen penale në ngarkim të shtetasit L. Q., për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal, që kanë lidhje me të njëjtën ngjarje. Nga aktet vërehet se:

- Më datë 17.01.2008, në {\*\*\*} të Sarandës, janë konfliktuar me mjete të forta z. F. D. me z. T., L. dhe E. Q.. Në bazë të ekzaminimeve mjeko ligjore, z. F. D. dhe T. Q. kanë marrë dëmtime të rënda. Për shkak të plagëve/dëmtimeve të pësuar, z. T. Q. është shtruar në spital më datë 05.02.2008 dhe më pas ka vdekur.
- Më datë 25.08.2009, pas hetimeve të kryera, oficeri i policisë gjyqësore ka relatuar te prokurori dërgimin e çështjes penale në gjyq, në ngarkim të z. F. D. dhe L. Q..
- Më datë 20.10.2008, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka marrë vendimin për marrjen të pandehur dhe njoftimin e akuzës për z. F. D. dhe për z. L. Q. (vendimi nuk i është njoftuar z. Q. dhe as mbrojtësit të tij), dhe ndarjen e çështjes penale nr. {\*\*\*}. Prokuroria ka arsyetuar se hetimet për të pandehurin F. D. janë të plota, ndërsa për të pandehurin L. Q. është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera. Procedimet penale janë ndarë përkatësisht në:
  - i) çështjen penale nr. {\*\*\*} në ngarkim të z. F. D. për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje” me pasojë vdekjen e z. T. Q., të parashikuar nga neni 88/2 i K.Penal dhe dërgimin e kësaj çështjeje për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë; dhe
  - ii) çështjen penale nr. {\*\*\*} në ngarkim z. L. Q. për veprën penale “Plagosje e rëndë në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, parashikuar nga neni 88/b i K.Penal.
- Më datë 27.09.2009, prokurori vendosi pushimin e çështjes nr. {\*\*\*}, bazuar në nenin 19 të K.Penal dhe në nenin 328/1, germa “f” e K.Pr.Penale, me arsyetimin se L. Q. ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim z. F. D.. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, me vendimin e datës 14.04.2010, për shkak të mosparaqitjes pa shkaqe të përligjura të palës ankuese/kërkuese, z.

D. dhe përfaqësuesit të tij. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 27.04.2010 pasi nuk u ankimua (sipas shënimit të kancelarit të gjykatës).

- Më datë 11.02.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë vendosi pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit F. D., me arsyetimin se nuk provohej që ai ishte autor i veprës penale. Bazuar në ankimin e ushtruar nga prokuroria dhe nga i pandehuri, Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin e datës 14.04.2010, e deklaroi të pafajshëm të pandehurin F. D.. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 26.01.2011, nuk e pranoi rekursin e ushtruar nga Prokuroria e Apelit Gjirokastër.

**29.2.** Në përmbajtjen e vendimit të datës 11.02.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka konstatuar një sërë mangësish dhe problematika mbi hetimin e kryer nga ana e prokurorisë dhe vendimin e dhënë për pushimin e hetimeve për çështjen penale nr. {\*\*\*}, në ngarkim të z. L. Q., si dhe për dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. {\*\*\*}, në ngarkim të z. F. D.. Referuar këtyre të dhënave, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se, me të drejtë, Komisioni ka evidentuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje. Ndërkohë që pretendimet e tij se çështja ishte trajtuar fillimisht nga një prokurore tjetër, e proceduar me masë shkarkimi nga detyra, pikërisht për ndërhyrje dhe manipulime në dosje, tregojnë një qasje të subjektit që kufizohet me shfajësime, për të evituar përgjegjësinë në kushtet kur rezulton të mos ketë kryer me profesionalizëm detyrën e tij, mangësi këto të evidentuara nga gjykata në procedimin nr. 24, në ngarkim të z. F. D., dhe nga Prokuroria e Përgjithshme në procedimin nr. {\*\*\*}, në ngarkim të z. L. Q.. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara në fakte.

- 30.** Subjekti argumenton se për sa i përket çështjes që lidhet me z. K. H., lloji i masës së sigurimit për një të dyshuar nuk ka të bëjë me fajësinë apo pafajësinë, ndërkohë që Komisioni e ka trajtuar këtë çështje si gjykim themeli. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1/2008 që referon Komisioni, ka të bëjë me gjykimin e themelit dhe jo me llojin e masës së sigurimit. Subjekti argumenton se masa e sigurimit “Arrest në burg”, me afat 30-ditor bazohet në ligjin procedural penal për kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal ndaj të dyshuarit. Sipas aktit të ekspertimit, z. H. ka qenë përdorues i kokainës dhe është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, në formën e mbajtjes dhe jo të shpërndarjes. Gjykata ka vendosur dënim me burgim, por në aplikim të nenit 59 të K.Penal, është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burgim dhe ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në Gjykatën e Apelit.

**30.1.** Nga aktet e administruara, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka përcjellë në Komision vendimin [nr. {\*\*\*}, datë 06.08.2018], nëpërmjet të cilit, për të dyshuarin K. H. (dhe të dyshuarin tjetër F. G.), për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” [të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal] është pranuar kërkesa e prokurorit dhe vlerësuar i ligjshëm arrestimi i tij në flagrancë. Në vijim, është caktuar masë sigurimi personal arresti në burg. Gjykata e Apelit Gjirokastër, më datë 20.08.2018, ka vendosur miratimin e këtij vendimi. Prokurori i Apelit kërkoi miratimin e vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke kufizuar kohëzgjatjen e masës së sigurimit në 30 ditë, deri në administrimin e aktit të ekspertimit toksikologjik, për të vërtetuar faktin nëse i dyshuari është apo jo përdorues i lëndëve narkotike. Kjo kërkesë nuk është pranuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, e cila ka arsyetuar se edhe nëse merren të mirëqena shpjegimet e të dyshuarit, ai është përdorues i lëndës narkotike *cannabis* dhe jo i kokainës. Po kështu, në vlerësimin e gjykatës, nga rrethanat e faktit krijohen dyshime për shpërndarje të lëndëve narkotike, veprimtari kriminale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore.

Sipas Gjykatës së Apelit, bazuar në këto dyshime, është çmuar se masa e përshtatshme për t'u aplikuar është ajo e arrestit në burg, sipas nenit 238 të K.Pr.Penale. Në përfundim të shqyrtimit në themel të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, më datë 14.11.2018, vendosi të deklarojë fajtor të pandehurin për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë i Kodit Penal dhe e dënoi me vënie në periudhë prove për një afat prej 3 vitesh. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 03.12.2018, pasi nuk u ankimua nga palët. Nga përmbajtja e vendimit, konstatohet se është kryer akti i ekspertimit kimik dhe toksikologjik, nga ku ka rezultuar se i pandehuri është përdorues i lëndës narkotike, përfshirë edhe atë të llojit kokainë, dhe që sasia e lëndës narkotike të sekuestruar nuk mund të konsiderohet dozë e vogël (referuar edhe vendimit unifikues nr. 1/2008). Sipas gjykatës, i pandehuri ka konsumuar elementet e veprës penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, të parashikuar nga neni 283, paragrafi i parë i K.Penal.

**30.2.** Trupi gjykues i Kolegjit vëren se është në diskrecionin e prokurorit të parashtrorë kërkesa përpara gjykatës lidhur me llojin e masave të sigurimit personal, bazuar në provat e administruara gjatë hetimit – referuar parashikimeve të nenit 244 të K.Pr.Penale. Në konkluzionet e datës 20.08.2018, subjekti i rivlerësimit është shprehur se masa e sigurimit “Arrest në burg” është e përshtatshme, ka theksuar nevojën e ekspertimit toksikologjik dhe sasinë e vogël të lëndës narkotike<sup>36</sup>. Referuar vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, sikurse është shprehur edhe vetë subjekti i rivlerësimit, do të duhej të verifikohet nëpërmjet ekspertimit toksikologjik nëse z. H. është përdorues i lëndës narkotike të sekuestruar (pasqyrim i gjetur edhe në vendimin nr. {\*\*\*} të gjykatës). Në këtë kontekst, vlerësimi i Komisionit se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e masës së sigurimit nuk është në përputhje me legjislacionin dhe praktikën gjyqësore, nuk është bindës.

**30.3.** Nga ana tjetër, argumentimi i subjektit të rivlerësimit se vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1/2008 ka të bëjë me gjykimin e themelit dhe jo me llojin e masës së sigurimit, nuk është i saktë. Pavarësisht se Gjykata e Lartë në këtë vendim ka marrë në shqyrtim një çështje të gjykuar në themel, unifikimi i praktikës gjyqësore nga Gjykata e Lartë, lidhur me kuptimin ligjor të nocionit “dozë e vogël” për lëndët narkotike, në kuptimin e nenit 283/1 të Kodit Penal, duhet të mbahet në konsideratë në çdo fazë të shqyrtimit të një çështjeje penale që ka për objekt kryerjen e kësaj vepre penale.

**31.** Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit se subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia është i gabuar. Nuk janë marrë parasysh shpjegimet e tij gjatë hetimit administrativ mbi arsyetimin e vendimeve dhe bazën ligjore, parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, mbi të cilat duhet të kryente vlerësimin. Vlerësimi i një rasti të vetëm nuk mund të shërbejë si standard për të konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia. Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisioni është i padrejtë edhe për thelbin e tij. Nga denoncimet e publikut nuk rezultuan rrethana që mund të rëndojnë pozitën e subjektit të rivlerësimit në aspektin profesional.

**31.1.** Komisioni ka analizuar mangësinë që lidhen me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit në kontekstin e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale. Nga shqyrtimi i vendimit, konstatohet se pas vlerësimit të kryer për mangësitë e evidentuara, Komisioni nuk ka disponuar me masë disiplinore për shkarkimin nga detyra, në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 –

---

<sup>36</sup> *Sasia e lëndës së sekuestruar ka qenë 0,25 gramë lëndë e narkotike, e llojit kokainë, dhe 24 gramë lëndë narkotike, e llojit “cannabis sativa”.*

*kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale – pavarësisht se ka konkluduar që mangësitë e evidentuara nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Mangësitë e evidentuara veç e veç e në tërësi, Komisioni i ka arsyetuar në drejtim të mosarritjes së një niveli të besueshëm, pasi është cenuar besimi i publikut te sistemi i drejtësisë.*

**31.2.** Kështu, në rastin e disponimit për mosfillimin e një procedimi penal mbi bazën e kallëzimit penal që ngarkonte me përgjegjësi konkrete një prej gjyqtarëve të gjykatës së rrethit gjyqësor pranë të cilit ushtronte veprimtarinë edhe prokuroria në të cilën shërbente subjekti, përpos vlerësimit bazik nëse kishte ose jo elemente të veprës penale, në zbatim të përcaktimit të nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale, ky vlerësim do të duhet të ishte kryer nga një prokuror i një prokurorie tjetër. Nga një lexim i thjeshtë i kësaj dispozite, kuptohet kujdesi që ka treguar legjislatori për të krijuar kushtet e paanësisë objektive në punën e përditshme. Dispozita ka për qëllim po ashtu të shmangë çdo dyshim apo perceptim në sytë e një vëzhguesi të jashtëm për favorizim të mundshëm nga njerëzit e drejtësisë ndaj autorëve të veprave penale që mund të jenë vetë njerëzit e drejtësisë, çka bën që besimi i publikut të cenohet. Disa mangësi profesionale, sikurse mosnjohimi i vendimeve të mosfillimit apo të pushimit, apo moskryerja e veprimeve hetimore të plota, janë evidente dhe të ndeshura shpesh si në raste, ashtu edhe në kohë të ndryshme. Përpos kësaj, edhe qëndrimi i shprehur nga subjekti i rivlerësimit në ankim se, pavarësisht mosnjohimit të vendimit, kallëzuesi [z. P.] nuk e ka humbur të drejtën e ankimit apo se ky mosveprim është edhe përgjegjësi e administratës së prokurorisë, nuk mund të përbëjë justifikim dhe logjikë për moszbatimin e një detyrimi ligjor.

**31.3.** Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i Komisionit se mangësitë e konstatuara në aspektin profesional nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit, nuk është i qartë dhe bindës. Nga ana tjetër, dy çështjet penale të analizuara në funksion të kriterit të vlerësimit profesional, një ndër të cilat lidhet me kallëzimin penal në ngarkim të një funksionari të sistemit të drejtësisë, kanë dëshmuar se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij që favorizonin një magjistrat tjetër, dhe duke krijuar kushtet e klimës së pandëshkueshmërisë në sytë e publikut, ka cenuar besimin e publikut te drejtësia. Siç shtjellohet me sipër gjerësisht, shmangia e kryerjes së hetimeve apo moskryerja e veprimeve procedurale, ka pasur pasoja serioze në vijimin e procedimeve penale përkatëse, por në procesin e rivlerësimit vlerësohet në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**32.** Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, konstatoi se:

- i) për pasurinë e paluajjtshme apartament banimi me sip. 68,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastër, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te drejtësia pasi ka mungesë vërtetësie të deklarimeve të tij në deklaratën e pasurisë dhe në procesin e rivlerësimit, duke deklaruar në mënyrë të pasaktë në deklaratën *vetting*, burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke qenë kontradiktor në shpjegimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit në raport me të dhënat e dokumentacionit të administruar, si dhe në analizën tërësore të rrethanave, në të cilat pretendohet të jetë marrë huaja – nga fondet familjare të një funksionareje drejtuese të bankës për të anashkaluar politikat e bankës për kreditë;
- ii) subjekti i rivlerësimit në dy çështje penale të analizuara në funksion të kriterit të vlerësimit profesional, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, duke shmangur kryerjen e verifikimeve të të dhënave apo duke kryer veprime procedurale me pasoja

serioze në vijimin e procedimeve penale përkatëse. Një ndër këto çështje lidhet me një kallëzim penal në ngarkim të një funksionari të sistemit të drejtësisë.

33. Mbështetur në vlerësimet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit të gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, vendimi i Komisionit nr. 177, datë 08.07.2019, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 177, datë 08.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Alfred Agolli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 13.07.2021.

#### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi – kundër*

#### **ANËTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi – kundër*

## MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Albana Shtylla dhe Ina Rama, kemi votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Alfred Agolli kundër vendimit nr. 177, datë 08.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), nëpërmjet të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit të mësipërm të Komisionit dhe është konfirmuar shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Alfred Agolli, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.
2. Shumica e trupit gjykues, në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ka konkluduar se:
  - iii) *për pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sip. 68,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastrë, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë pasi ka mungesë vërtetësie të deklarimeve të tij në deklaratën e pasurisë dhe në procesin e rivlerësimit, duke deklaruar në mënyrë të pasaktë, në deklaratën “vetting”, burimin e krijimit të kësaj pasurie, duke qenë kontradiktore në shpjegimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit në raport me të dhënat e dokumentacionit të administruar, si dhe në analizën tërësore të rrethanave, në të cilat pretendohet të jetë marrë huaja – nga fondet familjare të një funksionareje drejtuese të bankës për të anashkaluar politikën e bankës për kreditë;*
  - iv) *subjekti i rivlerësimit në dy çështje penale të analizuar në funksion të kriterit të vlerësimit profesional, me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë, duke shmangur kryerjen e verifikimeve të të dhënave apo duke kryer veprime procedurale me pasoja serioze në vijimin e procedimeve penale përkatëse. Një ndër këto çështje lidhet me një kallëzim penal në ngarkim të një funksionari të sistemit të drejtësisë.*
3. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e ka gjetur të bazuar konkluzionin e Komisionit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit nr. 177, datë 08.07.2019.
4. Sa u përket fakteve të rezultuara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe të analizuar edhe nga shumica në vendim, ato nuk do të citohen në mënyrë të detajuar, përveçse kur do të nevojiten gjatë arsyetimit në këtë mendim pakice.
5. Në vlerësimin e pakicës, bazuar në faktet dhe provat e administruara dhe analizuar në kuadër të këtij procesi, si dhe në interpretim të ligjit të zbatueshëm lidhur me to, vendimi i Komisionit nr.177, datë 08.07.2019, duhej të ndryshohej dhe subjekti i rivlerësimit Alfred Agolli duhej të konfirmohej në detyrë.

### **I. Për pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sip. 68,5 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Gjirokastrë**

6. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit Alfred Agolli ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me burimin e ligjshëm që ka shërbyer për pasurinë apartament banimi me sip. 68,5 m<sup>2</sup> (në vijim “pasuria apartament banimi”), bazuar në situatën faktike dhe provat e administruara në Komision dhe në analizë të shkaqeve të ankimit dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit Alfred Agolli, për saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të tij, si dhe të ligjshmërisë së burimit për krijimin e kësaj pasurie, kemi qëndrimin si më poshtë vijon.



6.1. Pakica ndan të njëjtin qëndrim me shumicën e trupit gjykues sa i përket pasaktësisë në deklaratën *vetting*, për mosdeklarimin e huas së marrë nga z. N. Dh. si burim krijimi për pasurinë apartament banimi, si dhe për deklarimin jo të saktë të datës kur është fituar pronësia nga subjekti i rivlerësimit mbi këtë pasuri. Në vlerësimin tonë, në deklaratën *vetting*, subjekti duhet të kishte deklaruar si burim për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë, huan e marrë nga z. Dh., bazuar në parashikimet e nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”) dhe të pikës 7 të udhëzimit nr. {\*\*\*} të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, duke deklaruar në këtë mënyrë burimin e përdorur prej tij për këtë pasuri, në momentin e krijimit/fitimit të saj.

6.2. Pavarësisht sa më sipër konkluduar, vlerësojmë se deklaratimet e pasakta në deklaratën *vetting*, aktet noteriale dhe veprimet juridike të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit me shitësin e pasurisë apartament banimi, z. V. B., dhe huadhënësin, z. N. Dh., nëpërmjet të cilave ai ka synuar të fitojë pronësinë mbi pasurinë apartament banimi dhe financimin e blerjes së kësaj pasurie, fillimisht me anë të huas me z. Dh. dhe më pas me kredinë bankare të përfituar nga Raiffeisen Bank, të përshkruara në mënyrë të detajuar në arsyetimin e shumicës së trupit gjykues të Kolegjit, nuk mund të konsiderohen se janë të mjaftueshme, si dhe të kenë qenë veprime apo sjellje të tilla që të konkludohet se subjekti i rivlerësimit, në raport me kontrollin e kriterit të pasurisë, nuk ka arritur një nivel të besueshëm sipas nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, apo që të passjellin cenim të besimit të publikut te drejtësia, sipas nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

7. Konkluzioni i mësipërm mbështetet në një vlerësim të ndryshëm nga shumica të situatës faktike dhe provave të administruara në procesin e hetimit administrativ në Komision, dhe konkretisht:

7.1. Nga aktet e administruara, rezulton se fitimi i pronësisë për pasurinë apartament banimi me sip. 67 m<sup>2</sup>, është bërë me kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. 867{\*\*\*} kol., datë 20.06.2007, të nënshkruar ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. V. B.. Çmimi i blerjes së kësaj pasurie, në kontratën e shitjes së sipërcituar, është dakordësuar që do të likuidohej nga subjekti i rivlerësimit pasi të akordohej një kredi bankare nga Raiffeisen Bank. Subjekti i rivlerësimit, nga aktet e administruara në Komision, rezulton se kishte aplikuar për kredi bankare në datën 06.06.2007, pra para nënshkrimit të deklaratës noteriale të datës 08.06.2007 me z. B., qëllimi i së cilës ishte premtimi i blerjes së një apartamenti në pronësi të këtij të fundit. Raiffeisen Bank, në datën 12.06.2007, ka kryer inspektimin e pasurisë apartament banimi në pronësi të z. B., dhe ka përgatitur raportin e vlerësimit të saj në datën 14.06.2007. Bazuar në sa më sipër, provohet se subjekti i rivlerësimit kishte nënshkruar akte dhe kishte ndërmarrë veprime konkrete, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi dhe rregullat e operatorit bankar, me qëllim përfitimin e një kredie bankare, akte/veprime këto të cilat janë pasuar më tej me akte dhe procedura të kryera nga vetë banka për akordimin e një kredie me kushte tregtare. Për më tepër, nga kronologjia e fakteve, rezulton se synimi i subjektit ishte të financonte blerjen e kësaj pasurie nëpërmjet kredisë që pritej të akordohej nga Raiffeisen Bank.

7.2. Gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se bashkë me përgjigjen e dërguar në datën 12.02.2018 nga Raiffeisen Bank, për llogaritë bankare dhe kreditë e marra nga subjekti i rivlerësimit, është përcjellë dhe kontrata e kredisë bankare për blerjen e pasurisë apartament banimi, si dhe kopja e deklaratës noteriale të nënshkruar në datën 21.06.2007, nga subjekti i rivlerësimit dhe huadhënësi N. Dh.. Gjithashtu, nga aktet e administruara, rezulton se regjistrimi i pasurisë është bërë në datën 20.06.2007 në ZVRPP Gjirokastër, përpara datës 25.06.2007, datë kur

është lëvruar kredia bankare. Në fashikullin gjyqësor të çështjes, është administruar dhe dëshmia e dhënë gjatë hetimit administrativ në Komision nga znj. R. Dh., në të cilën pasqyrohen arsyet të cilat nxitën subjektin e rivlerësimit në hyrjen në një marrëdhënie huamarrjeje me z. N. Dh., për pagimin e çmimit të blerjes së pasurisë apartament banimi. Në vlerësim të provave të sipërcituara, pakica konkludon se rezulton e provuar bindshëm që çmimi i blerjes së pasurisë apartament ka pasur si burim huan e dhënë nga z. N. Dh.. Në vlerësimin tonë, deklarata noteriale e datës 21.06.2007, e nënshkruar nga subjekti dhe z. Dh., e administruar në dosjen e kredisë së Raiffeisen Bank, merr një rëndësi të posaçme për vlerën e saj provuese si një akt i krijuar në kohën kur ka ndodhur transaksioni për pagimin e çmimit të blerjes së pasurisë, e cila, e parë në harmoni me provat e tjera të sipërcituara, çmohet nga pakica se krijon bindjen se burimi që ka shërbyer për pagimin e çmimit të pasurisë, në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes, në datën 20.06.2007, ka qenë huaja e dhënë nga z. N. Dh.. Nga aktet, rezulton se kjo hua ka shërbyer si një mjet për financimin e blerjes së pasurisë vetëm për 5 (pesë) ditë, deri në ditën kur kredia u disbursua nga banka dhe huaja e marrë u shlye nëpërmjet saj, duke potencuar në këtë mënyrë vullnetin dhe synimin e subjektit që financimin e kësaj pasurie ta mundësonte nëpërmjet kredisë bankare dhe duke i dhënë kuptim e arsye deklarimit të kredisë si burim i krijimit të kësaj pasurie. Në këtë kontekst, ndonëse në kuptimin formal, huaja ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, dhe mosdeklarimi i saj në deklaratën *vetting*, konsiderohet si pasaktësi në deklarim. Koha shumë e shkurtër e ekzistencës së kësaj marrëdhënieje dhe shuarja e saj nëpërmjet kredisë, siç edhe ishte parashikuar të ndodhte, zbehin peshën e deklarimit të pasaktë në lidhje me të, në kuptimin e shkeljes që mund të prodhojë konsekuenca në procesin e rivlerësimit.

7.3. Në zbatim të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, z. Dh., për shkak të marrëdhënies huadhënës-huamarrës me subjektin e rivlerësimit Alfred Agolli, është konsideruar nga Komisioni si person tjetër i lidhur. Nga analiza financiare e bërë në Kolegj, sipas akteve të administruara në Komision dhe atyre të depozituara nga subjekti bashkëlidhur ankimit, siç konfirmohet dhe nga shumica në vendim, rezulton se, bazuar në një vlerësim tërësor të të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes Dh., ai ka pasur mundësi që të mbulojë me të ardhura të ligjshme shumë prej 3 milionë lekësh, dhënë hua më 20.06.2007, subjektit të rivlerësimit Alfred Agolli. Në këto kushte, pakica konkludon se subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin kushtetues sipas parashikimit të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, duke justifikuar bindshëm se çmimi për blerjen e pasurisë apartament, ka si burim të ardhura të ligjshme, në përputhje me përcaktimet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

8. Në përfundim, pakica vlerëson se, pavarësisht pasaktësive në deklarim, nuk konstatohen elemente që tregojnë përpjekje të subjektit të rivlerësimit Alfred Agolli për të kryer veprime apo sjellje të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi, të cilat të kenë pasur për qëllim, justifikimin e pasurive të fituara me burime të paligjshme, mungesën e burimeve të ligjshme apo mbulimin e pasaktësive në deklaratimet e bëra në deklaratën *vetting*, përfshirë këtu dhe fshehje pasurie apo deklarime të rreme lidhur me të.
9. Jemi shprehur kundër qëndrimit të shumicës dhe për sa u përket cilësimeve si shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016:
  - a) të pasaktësive në deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting* për burimin dhe kohën e krijimit të pasurisë apartament banimi; si dhe
  - b) të sjelljes dhe marrëdhënies së krijuar me bashkëshortët Dh. në drejtim të marrjes së huas dhe kryerjes së veprimeve me qëllim akordimin e kredisë bankare.

Në vlerësimin e pakicës, pasaktësitë e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, për çështjet e analizuara dhe konkluduara më sipër në këtë mendim pakice, si dhe marrëdhënia e krijuar dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit Alfred Agolli me bashkëshortët Dh., nuk mund të konsiderohen si veprime apo sjellje joetike që kanë cenuar besimin e publikut të drejtësia.

**9.1.** Lidhur me pasaktësitë në deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting*, për burimin dhe kohën (datën) e krijimit të pasurisë apartament banimi, pakica ka konkluduar si dhe shumica se ato nuk janë të një rëndësie të tillë që të mund të konsiderohen të mjaftueshme për t'u marrë në konsideratë për të konkluduar sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në ndryshim nga shumica, pakica ka vlerësuar se këto pasaktësi nuk mund të konsiderohen me një peshë të rëndësishme dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, për t'i kualifikuar ato sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**9.2.** Sa i përket marrëdhënies me z. N. dhe znj. R. Dh., nga hetimi i kryer në Komision, nuk rezultojnë që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit, apo kjo marrëdhënie të ketë sjellë për të një trajtim preferencial në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, meqenëse znj. Dh. ishte në cilësinë e drejtueses së filialit të Raiffeisen Bank në Gjirokastrë. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk rezultojnë që subjekti i rivlerësimit të ketë marrë trajtim preferencial apo të favorshëm, siç shumica thekson, lidhur me kushtet dhe termet e përfitimit të kredisë bankare. Përkundrazi, siç rezultojnë nga dëshmia e dhënë prej znj. R. Dh. në Komision, ajo i ka bërë të ditur subjektit se ai nuk mund të përfitonte kredinë bankare nëse nuk vendoste si garanci pasurinë apartament banimi, siç parashikonin rregullat dhe politikat e vendosura nga banka për këto lloj transaksionesh financiare. Për më tepër, pakica sjell në vëmendje se huaja e dhënë nga bashkëshorti i saj, z. Dh., pati një kohështrirje vetëm 5-ditore, nga data 20 qershor deri më 25 qershor 2007, si dhe nuk solli asnjë përfitim apo vlerë të shtuar për bashkëshortët Dh.. Në vlerësimin e pakicës, arsyet të cilat kanë shtyrë subjektin e rivlerësimit Alfred Agolli për të hyrë në një marrëdhënie huamarrjeje me z. N. Dh., pavarësisht pozicionit që ka pasur bashkëshortja e këtij të fundit në filialin në Gjirokastrë të Raiffeisen Bank, apo detyrës që ushtronte subjekti, janë të përligjura me nevojën e tij për të paguar çmimin e dakordësuar për blerjen e së vetmes pasuri dhe fitimin e pronësisë së saj. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe sjelljen e tij, nuk provohet që të ketë vepruar në keqbesim me Raiffeisen Bank, për sa kohë që në përmbajtjen e kontratës bankare specifikohet se qëllimi i përfitimit të saj është financimi i pasurisë apartament banimi. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, rezultojnë se në përfundim kjo kredi ka shërbyer për të shlyer huan e marrë nga z. N. Dh., për pagimin e çmimit të blerjes së të vetmes pasuri të subjektit, një apartament banimi i ndërtuar në vitet '80 dhe i blerë në vitin 2007. Për më tepër, veprimet dhe transaksionet e kryera nga subjekti i rivlerësimit për financimin e çmimit të blerjes së pasurisë apartament banimi, nuk e vendosin atë në kushtet e paligjshmërisë së burimit për krijimin e saj.

**10.** Bazuar në këtë vlerësim, pakica konkludoi se nuk konstatoi veprime apo sjellje të subjektit të rivlerësimit Alfred Agolli, të cilat ishin joetike dhe që mund të konsideroheshin në cenim të besimit të publikut, në përputhje me përcaktimet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

## **II. Mbi kriterin e aftësive profesionale**

**11.** Në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, pakica ka ndarë qëndrim të ndryshëm nga shumica si për sa i përket konstatimit të shkëlqeve, ashtu edhe vlerësimit të tyre dhe peshës që ato duhet të kenë në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit. Siç rezultojnë edhe nga

përmbajtja e arsytimit të vendimit, kriteri i aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, është vlerësuar mbështetur në problematikën e dy procedimeve penale të regjistruara e të hetuara nga zyra e prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në të cilat subjekti ka qenë prokuror dhe drejtues i saj.

**11.1.** Pakica ka ndarë qëndrim të ndryshëm nga shumica, së pari lidhur me problematikën e evidentuar në procedimin nr. {\*\*\*} që i përket kallëzuesit N. P. e që i është atribuar gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë (në kohën e depozitimit të tij), z. P. A..

**11.2.** Nga aktet e administruara, ka rezultuar se ndaj gjyqtarit P. A. është depozituar një kallëzim penal në Prokurorinë e Përgjithshme në datën 14.01.2013 nga shtetasi N. P., i cili është regjistruar me këtë cilësi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë në datën 26.03.2013, sapo ky akt procedural ka mbërritur në këtë zyrë nga Prokuroria e Përgjithshme. Subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë vendosur mosfillimin e procedimit penal për hetimin e këtij kallëzimi në datën 03.05.2013. Në arsyetimin e vendimit të mosfillimit, rezulton që subjekti të ketë përdorur si argument faktin se një procedim tjetër penal që ishte regjistruar, kishte hetuar të njëjtat fakte në vitin 2011 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i cili ishte pushuar me vendim të asaj prokurorie. Nga kallëzimi penal i trajtuar prej subjektit, rezulton se janë dhënë njoftime për faktet e ndodhura në vitin 2011 e të hetuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, por edhe për fakte të reja të pretenduara se kanë ndodhur rishitas e që lidhen me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit të kallëzuar. Në këtë drejtim, pakica ndan qëndrim të ngjashëm me shumicën, se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar në mënyrë jo të plotë vendimin e tij të mosfillimit, duke përdorur si argument vetëm fakte që lidheshin me episodin e hetuar dhe nuk ka arsyetuar në mënyrën e duhur për rrethanat që e kanë ndaluar atë të nisë një procedim penal në lidhje me episodin e ri, të pretenduar prej kallëzuesit se ka ndodhur në datën 07.01.2013, në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, një ditë para dhënies së një vendimi në dëm të interesave të kallëzuesit prej gjyqtarit P. A.. Ndërkohë që arsyetimi i përdorur prej subjektit mbulonte vetëm një pjesë të fakteve të pretenduara në kallëzim, vendimi do të duhej të pasqyronte në mënyrë të plotë edhe pasqyrimin e rrethanave që pengonin hetimin e fakteve të reja.

**11.3.** Në kuptim të neneve 290 e 291 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori është i detyruar të kryejë verifikimet paraprake të një materiali kallëzues, me qëllim vlerësimin e rrethanave e fakteve që janë pjesë e tij, nëse ato përbëjnë njoftime se një veprë penale ka ndodhur dhe se një procedim penal duhet regjistruar për t'i hetuar ato. Nga aktet e administruara, rezulton se në kallëzim pretendohet se gjyqtari P. A. kishte takuar në ambientet e gjykatës një shtetas i cili ishte i afërm me palën kundërshtare të kallëzuesit në procesin civil, i cili i kishte dhënë gjyqtarit tekstin e vendimit që ai do të shpallte të nesërmen. Ky pretendim i parashtruar në kallëzim, nuk rezulton të jetë shoqëruar me ndonjë element provues apo që jepte indicie për ngjarjen e ndodhur. Në këto kushte, veprimi i parë që mund të kryhej, në kuadër të verifikimit të vërtetësisë së fakteve të parashtruara në kallëzim, do të ishte këqyrja e pamjeve filmike të regjistruara nga sistemi i kamerave të gjykatës, e cila do të konfirmonte ose jo ngjarjen e pretenduar, rrethanë e cila do të duhej të vlerësohej më pas nga subjekti në drejtim të mundësisë së regjistrimit të procedimit penal e kryerjes së veprimeve hetimore për zbardhjen e ngjarjes. Subjekti ka pretenduar se ky veprim ishte i pamundur të kryhej për shkak të kohës së gjatë që kishte kaluar nga koha e ndodhjes së ngjarjes e mbërritjes në zyrën e tij të kallëzimit penal.

Në këto kushte, duket se kallëzimi penal ka mbetur i pambështetur me të dhëna të vlefshme për regjistrimin e një procedimi penal sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, i cili do të mundësonte më pas kryerjen e një veprimtarie hetimore të dedikuar zbardhjes së ngjarjes.

**11.4.** Duke ndarë të njëjtin qëndrim me shumicën për sa i përket sensitivitetit e kujdesit që duhet të kishte pasur subjekti i rivlerësimit ndaj ndjekjes e vlerësimit të duhur të rastit në fjalë për shkak se flitej për një funksionar të drejtësisë, pakica çmon se vlerësimi i rrethanave konkrete të pretenduara në kallëzim e të vëna në dijeni të subjektit me vonesë, nuk lejonin plotësisht ushtrimin e funksioneve në nivelin e duhur e të kënaqshëm, në përputhje me dispozitat ligjore procedurale në fuqi. Hetimi dhe ndjekja penale për episode të tilla kërkon dinamikë në ndjekje, bashkëpunim e përdorim të metodave të posaçme të hetimit për të qenë të suksesshëm, dhe sigurisht një bazë informacioni të besueshëm e të mbështetur, për të legjitimuar të gjithë veprimtarinë hetimore, e cila në rastin konkret do të duhej të zhvillohej nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në rast se procedimi penal do të regjistrohej në zbatim të nenit 78 të Kodit të Procedurës Penale.

**11.5.** Në këto kushte, pakica vlerëson se qëndrimi i subjektit në raport me këtë vendim do të duhet të konsiderohet brenda kontekstit të përshkruar më lart, me qëllim përcaktimin e peshës që sjellja e tij procedurale në këtë rast do të ketë në raport me të gjithë procesin e tij të rivlerësimit.

- 12.** Në lidhje me procedimet nr. {\*\*\*} dhe {\*\*\*} të vitit 2008, të përshkruara në mënyrë të plotë në arsyetimin e shumicës, pakica ndan qëndrim të ndryshëm për sa i përket përcaktimit të rolit dhe përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në veprimet procedurale të ndërmarra për përfundimin e këtij procedimi penal.

**12.1** Duke qenë dakord me qëndrimet e shumicës që përcaktojnë se ka veprime procedurale të subjektit të rivlerësimit të cilat janë konsideruar jo në përputhje me dispozitat procedurale, siç është ndarja e procedimeve penale që u përkisnin shtetasve F. D. e L. Q. apo renditja në listën e dëshmitarëve të shtetasit L. Q., ndërkohë që ai ishte i bashkëpandehur në çështje, pakica çmon se ka qenë e pamundur objektivisht të përcaktohet roli dhe të individualizohet përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit në çështjen objekt analize, duke qenë se pjesa thelbësore e hetimit për këtë çështje është kryer nga një tjetër prokuror.

**12.2** Duke pasur në konsideratë rrethanat historike të zhvillimit të procedimit në fjalë, pavarësisht veprimtarisë hetimore jo të plotë e shteruese që evidentohet në ushtrimin e funksioneve të subjektit si prokuror i çështjes, mbetet konkluzion i paqartë dhe i pasigurt, ai që bën përgjegjës subjektin për shkeljet e konstatuara, për më tepër që kjo përgjegjësi, tejet e dyshimtë dhe e prejardhur, ngrihet në nivelin e një shkeljeje që vlerësohet me peshë në procesin e tij të rivlerësimit.

**12.3** Në vlerësimin e këtyre çështjeve të analizuara, të cilat kanë shërbyer si bazë vlerësimi për vendimin e shumicës në kontekstin e vlerësimit të përgjithshëm të kriterëve të rivlerësimit, pakica ka në konsideratë edhe arsyetimin pajtues të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, i cili kërkon që shkelja e konstatuar të jetë e rëndë dhe serioze, në mënyrë që ajo të konsiderohet në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale. Në vlerësimin tonë, problematikat e hasura në të dyja çështjet e analizuara, nuk konsiderohen as serioze dhe as të rënda, për pasojë ato nuk afektojnë konkluzionin se subjekti arrin nivel minimal kualifikues sipas nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk mund të luajnë një rol të posaçëm në vlerësimin tërësor të procesit të rivlerësimit sipas nenit 4, pika 2 e këtij ligji.

### **III. Mbi zgjidhjen e çështjes**

13. Në përfundim, bazuar në arsyetimin e mësipërm, pakica, në bazë të autoritetit diskrecional të gjykatës për zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, i konsideroi konkluzionet e Komisionit për kontrollin e kriterit të pasurisë dhe të aftësive profesionale, si të pamjaftueshme për t'u kualifikuar sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Në këto kushte, pakica vlerësoi se subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, duke arritur në një nivel të besueshëm në vlerësimin e të tria kriterëve të rivlerësimit.

14. Bazuar në sa më sipër, përfundimisht ne gjyqtaret në pakicë vlerësuam se, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, vendimi i Komisionit nr. 177, datë 08.07.2019, duhej të ndryshohej dhe subjekti i rivlerësimit Alfred Agolli të konfirmohej në detyrë.

**GJYQTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*